



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 38 regjistër (JR)
Datë 05.12.2018

Nr. 30 i vendimit
Datë 18.11.2019

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga:

Luan Daci	Kryesues
Albana Shtylla	Relatore
Ardian Hajdari	Anëtar
Ina Rama	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 18.11.2019, ditën e hënë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar John Leonardo, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Ahmet Jangulli, gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 67, datë 05.10.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Nenet 6 e 13 të KEDNj-së, nenet 4, 7, 17, 42, 116, 142, 149/d, 179/b e 180 të Kushtetutës, nenet Ç, D, Dh, E dhe F, pikat 5 e 7 të Aneksit të Kushtetutës, neni 62 e vijues, neni 66, pika 1, shkronjat “b” e “c” të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, nenet 46 e vijues të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Albana Shtylla, shqyrtoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit

nëpërmjet të cilave ai kërkoi shfuqizimin e vendimit nr. 67, datë 05.10.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Ahmet Jangulli, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar me përparësi në kohë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 276 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, duke qenë se ishte kandidat për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Komisioni ka kryer procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Ahmet Jangulli (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), bazuar në të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

Komisioni ka administruar raportet e hartuara nga organet ligjzbatuese, sipas të cilave:

1.1 Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:

- Deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin.
- Nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.
- Ka kryer fshehje të pasurisë.
- Ka kryer deklarim të rremë.
- Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

1.2 Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar, duke konkluduar: “Papërshtatshmërinë për ushtrimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Ahmet Jangulli”.

1.3 Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “KLD”) ka kryer analizën e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit.

2. Komisioni, bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe Inspektorati i KLD-së, kreu procedurën e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), në bazë të nenit 58, pika 1, shkronja “c”, si dhe të nenit 61, pikat 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 67, datë 05.10.2018 (në vijim “vendimi”), ka vendosur:
 - *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Ahmet Jangulli, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.*

- *Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.*
- *Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.*
- *Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*

4. Vendimmarrjen e tij, Komisioni e ka mbështetur në konkluzionet e mëposhtme.

4.1 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

4.2 Për kriterin e kontrollit të figurës, në bazë të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nga analiza e të dhënave të parashikuara në pikën 1, neni 38 i ligjit nr. 84/2016, dhe bazuar edhe në raportin e DSIK-së, duhet aplikuar pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, për deklaram të pamjaftueshëm për këtë kriter.

4.3 Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit nuk arrin një nivel minimal kualifikues profesional. Për pasojë, në zbatim të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, rezulton “i papërshtatshëm” nga vlerësimi i aftësive profesionale.

4.4 Në vlerësimin tërësor të të tria kriterëve, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, duke analizuar konstatimet mbi:

- kriterin e vlerësimit të pasurisë, sikurse janë deklaramet kontradiktore dhe veprimet fiktive, mbi të ardhurat nga fitimi i aktivitetit të bashkëshortes, deklaramet e likuiditeteve *cash* pranë ILDKPI-së, vlerësohet se ato janë në atë nivel që të çojnë në lindjen e dyshimeve për të ardhura të pajustificuara, nga të cilat kanë ardhur pasuri të paligjshme financiare për subjektin e rivlerësimit;
- kriterin e kontrollit të figurës, sikurse është raporti i DSIK-së, si dhe materiale të tjera nga institucionet ligjzbatuese dhe konstatimet e Komisionit gjatë hetimit, mbi dosjen gjyqësore të subjektit krijohen dyshime mbi pastërtinë e figurës së subjektit të rivlerësimit;
- kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas raportit të institucionit përgjegjës IKLD-së, si dhe praktikës së procedimit disiplinor;
- si dhe denoncimet e publikut –

Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, referuar nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

5. Kundër vendimit nr. 67, datë 05.10.2018, të Komisionit ka bërë ankim subjekti i rivlerësimit Ahmet Jangulli¹, në mbështetje të neneve 6 e 13 të KEDNj-së, neneve 4, 7, 17, 42, 116, 142, 149/d, 179/b e 180 të Kushtetutës, neneve Ç, D, Dh, E dhe F, pikat 5 e 7 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 62 e vijues, nenit 66, pika 1, shkronjat “b” e “c” të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, neneve 46 e vijues të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”). Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar pavlefshmëri absolute dhe/ose

¹ Subjekti i rivlerësimit Ahmet Jangulli, më datë 19.11.2018, ka paraqitur ankimin e tij ndaj vendimit nr. 67, datë 05.10.2018, të Komisionit, ankim i cili u pranua nga trupi gjyqësor i Komisionit, me vendimin nr. 4, datë 19.11.2018.

shfuqizimin e vendimit administrativ nr. 67, datë 05.10.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nëpërmjet pranimit të ankimit, duke cenuar aktin administrativ në një nga format e cenimit, shfuqizimin/ndryshimin/rrëzimin/prishjen e aktit administrativ dhe konfirmimin në detyrë.

6. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit kundër vendimit të Komisionit, në mënyrë të përmbledhur janë si më poshtë.

6.1 Në lidhje me procesin e rregullt ligjor, subjekti ka pretenduar:

6.1.1 Komisioni nuk ka zbatuar procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe ka shkelur parimin e proporcionalitetit, pasi nuk e ka njoftuar për procedimin administrativ të zhvilluar ndaj tij. Bashkë me njoftimin për seancën dëgjimore, i ka bërë të ditur subjektit edhe të drejtën për të paraqitur dokumente me shkrim për vlerësimin e provave të administruara, rezultatet e hetimit dhe rezultatin e mundshëm të procedurës, në një kohë kur në rezultatet e hetimit administrativ nuk ka vlerësim për provat e administruara, nuk ka rezultate hetimi konkrete dhe nuk ka rezultate të mundshme të procedurës, në kundërshtim me parimin e objektivitetit, duke mos i dhënë mundësi subjektit të mbrohet në proces dhe as të dëgjohet përpara marrjes së vendimit përfundimtar. Komisioni ka shkelur parimet e përgjithshme mbi procedurën administrative, si: parimin e transparencës, informimit, dhënies së ndihmës aktive, ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, të drejtësisë dhe të paanësisë, si dhe të deburokratizimit dhe eficientës.

6.1.2 Në procesin e zhvilluar nga Komisioni është bërë një hetim i thelluar, por në fakt hetimi nuk thotë asnjë fjalë të vetme për hetimin shtesë dhe, në këto rrethana, të dhënat që dalin nga hetimi nuk dihet se ku bazohen, nëse bazohen në hetimin e subjekteve apo bazohen në hetimin e Komisionit. Hetimi nuk është bazuar në asnjë lloj prove që ka rezultuar nga hetimi i thelluar, por është bazuar në raportet e organeve të tjera.

6.1.3 Në seancë dëgjimore, Komisioni trajtoi prova të reja të cilat nuk ia bëri me dije seancës dhe as ia vuri në dispozicion subjektit të rivlerësimit, duke shkelur të drejtat e subjektit në proces. Në seancë dëgjimore subjektit nuk iu dha mundësia që të jepte shpjegime me hollësi, pasi iu kufizua mundësia për t'u shprehur, e megjithatë shpjegimet e subjektit nuk u kundërshtuan nga Komisioni, që do të thotë se ato qëndrojnë sipas versionit të shpjeguar prej tij.

6.1.4 Vendimi i Komisionit nuk ka formën ligjore, nuk përmban asnjë nga elementet e përcaktuara në nenin 57, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, duke qenë në kundërshtim flagrant me ligjin dhe si i tillë nuk mund të prodhojë pasoja ligjore. Vendimi nuk i është njoftuar subjektit konform kërkesave ligjore, pasi brenda afatit ligjor nuk ka vendim të shkruar, brenda këtij afati nuk ka as njoftim të këtij vendimi dhe, për rrjedhojë, për masën disiplinore shkarkim nga detyra nuk ka vendim dhe, vetëm për këto rrethana, subjekti kërkon konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të Komisionit. Vendimi është në shmangie të plotë të arsyetimit të rezultateve të hetimit administrativ dhe pretendimeve të subjektit për to, të përmbajtjes së akteve dhe të seancës dëgjimore, si dhe nuk shpjegon arsyet për këto shmangie.

6.1.5 Vendimi i Komisionit është i pavlefshëm, i marrë në kundërshtim me parimet e përgjithshme të procedurës administrative dhe, për pasojë, Kolegji duhet ta shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore me praninë e subjektit, duke i dhënë mundësi të dëgjohet e të mbrohet, në funksion të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike.

6.2 Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti ka pretenduar:

6.2.1 Për llogari të kontrollit të pasurisë është e treta herë që i nënshtrohet kontrollit, fillimisht në vitin 2009, më pas në vitin 2014 dhe tashmë për llogari të deklaratës së pasurisë së rivlerësimit. Për gjërat që ka kontrolluar Komisioni, në substancën e tyre dhe për më tepër në këndvështrimin që i ka parë, i takon qartësisht e plotësisht që subjekti të jetë para “gjësë së gjykuar”.

6.2.2 Konkluzioni i Komisionit se nuk ka burime të mjaftueshme financiare për blerjen e automjetit në vitin 2005 nuk qëndron, pasi Komisioni në analizën financiare nuk ka përlloritur saktë shpenzimet e jetesës për këtë vit, në kundërshtim me sa ka shpjeguar dhe pretenduar subjekti gjatë hetimit administrativ. Dyshimi i Komisionit për shkëmbimin në vitin 2012, të automjetit të blerë në vitin 2005, me një automjet i cili kishte vlerë më pak se gjysma e makinës që kishte pasur në pronësi subjekti, është i pabazuar në prova.

6.2.3 Në kundërshtim me sa ka konkluduar Komisioni, subjekti, në ILDKPKI dhe në organet tatimore për vitet 2006 dhe 2007, ka paraqitur jo vetëm aktet financiare me parregullsi, por edhe aktet financiare të sistemuara. Pasqyrat financiare për vitet 2006 dhe 2007, të cilave iu referohet Komisioni, nuk kanë vlerë juridike përballë deklaratave të qarkullimit vjetor të realizuar, të paraqitura pranë Bashkisë së Peshkopisë, sot Dibër. Komisioni, në analizën financiare për periudhën 2005-2012, ka trajtuar gabim të ardhurat nga biznesi i bashkëshortes së tij për vitet 2006 dhe 2007, si dhe nuk ka konsideruar pagën e saj si notere në asnjë vit.

6.2.4 Arsytimi i Komisionit për huadhënien e parave nga subjekti te persona të tretë, është alogjik dhe abuziv, pasi faktet që trajtohen nuk bazohen në deklaratat përkatëse dhe shpjegimet e subjektit të cituara edhe në vendim, të cilat qartësisht pasqyrojnë se gjendjen në lekë të dhënë hua, subjekti nuk e ka pasur të shpërndarë në vitin 2014, por ndër vite, duke pasur atë gjendje deri në fund të vitit 2016.

6.2.5 Konkluzioni i Komisionit për pasaktësitë në deklaratimet periodike të subjektit për gjendjen e likuiditeteve *cash* në vitet 2006, 2007 dhe 2008 është alogjik dhe abuziv, pasi faktet që trajtohen nuk bazohen në aktet përkatëse, të cilat qartësisht pasqyrojnë se për këto vite, pasaktësitë janë sistemuara nga subjekti në deklaratimet e bëra pranë ILDKPKI-së në vitet 2009 dhe 2014. ILDKPKI nuk i ka bërë pjesë të raportit të saj këto akte dhe as nuk ia ka vënë në dispozicion Komisionit. Konkluzioni i Komisionit është i paargumentuar, për rillogaritjet e kryera në vendim mbi rezultatet e hetimit administrativ, lidhur me gjendjen e *cash*-it, sepse sipas rillogaritjeve, diferenca e pajustificuar është në vlerë më të vogël sesa ajo e nxjerrë në rezultatet e hetimit administrativ.

6.2.6 Bashkëshortja e subjektit është trajtuar gabim si bashkëkredimarrëse në një kredi të marrë në Bankën Societe Generale Albania, pasi ajo në fakt ka qenë dorëzanëse. Për pasojë, konkluzioni i Komisionit për deklaratim të pamjaftueshëm për shkak të mosdeklarimit të kësaj kredie nga subjekti është arbitrar, pasi ai nuk kishte çfarë të deklaronte, në kushtet kur nuk kishte dijeni për veprimin dhe kur nuk bëhej fjalë as për pasuri dhe as për detyrime të familjes së tij.

6.3 Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, subjekti ka pretenduar:

6.3.1 Trajtimi i kontrollit të figurës i bërë në vendim, mbi informacionin e përcjellë nga DSIK-ja, nuk gjen pasqyrim në rezultatet e hetimit administrativ dhe, për këtë arsye, ai nuk ka dhënë sqarime lidhur me këtë çështje në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ. Komisioni nuk i ka kaluar barrën e provës lidhur me këtë kriter, pasi tjetër gjë është barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime për të provuar të kundërtën dhe krejt tjetër gjë

është dhënia e argumenteve në lidhje me konstatimet, në të cilat qartësisht pasqyrohet se nuk kërkohet asnjë lloj argumenti.

6.3.2 Për llogari të kontrollit të figurës, është e dyta herë që subjekti i nënshtrohet kontrollit, së pari në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe së dyti për llogari të deklaratës së kontrollit të figurës, prandaj, në këto rrethana, i takon qartësisht e plotësisht që të jetë para “gjësë së gjykuar”.

6.3.3 Arsyetimi i bërë në vendimin e Komisionit është alogjik dhe abuziv, pasi faktet që trajtohen nuk bazohen në aktet përkatëse që citohen edhe në vetë vendimin e Komisionit, sepse për sa i përket argumentit mbi të dhënat që kanë rezultuar nga procesverbalet e seancave gjyqësore, Komisioni ka pasqyruar më pak argument se sa në rezultatet e hetimit administrativ, ku është hequr pjesa që e ka mbajtur në këmbë hetimin, ndërsa në lidhje me kërkimet e prokurorit rezulton se ai ka bërë vetëm një kërkim para gjykatës.

6.3.4 Arsyetimi i Komisionit nuk është ligjor, pasi vlerësimi për kontrollin e figurës nuk është brenda periudhës së vlerësimit, në zbatim të ligjit nr. 84/2016. Përfundimi i Komisionit se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e figurës nuk qëndron dhe është alogjik e abuziv, sepse lehtësisht konstatohet se arsyetimi i vendimit bazohet vetëm në raportin e DSIK-së, pa hartuar Komisioni një raport të vetin për këtë kriter.

6.3.5 Konkluzioni i Komisionit se informacioni i dhënë nga DSIK-ja për veprime korruptive në bashkëpunim me një prokuror, gjen mbështetje edhe nga hetimi administrativ mbi dosjen, siç janë rrethanat e ndryshimit të kualifikimit të veprës penale për të akuzuarit, është alogjik dhe abuziv, pasi nuk arsyetohet për asgjë se çfarë ka vërejtur trupi gjykues për veprimet korruptive, nuk jep asnjë indicie, provë ose gjetje që lidhin veprimet korruptive me rrethanat e ndryshimit të kualifikimit të veprës penale, duke e vendosur subjektin në kushtet që nuk mund të japë asnjë argument për to. Arsyetimi i Komisionit nuk qëndron, pasi subjekti nuk ka lënë asgjë pa deklaruar për llogari të kontrollit të figurës, sipas formularit përkatës të deklaramit. Aktet që citohen në vendimin e Komisionit provojnë se subjekti ka një nivel të besueshëm, për sa i përket kontrollit të figurës.

6.4 Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, subjekti ka pretenduar:

6.4.1 Për llogari të vlerësimit profesional i është nënshtuar kontrollit katër herë, një herë para Inspektoratit të KLD-së me arkivimin e ankesës, një herë në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë me shfuqizimin e vendimit nr. {***}, datë 03.03.2015, të KLD-së për masën disiplinore “Vërejtje me paralajmërim”, një herë para KLD-së me rrëzimin e kërkesës së ministrit të Drejtësisë për propozimin për masën disiplinore “Shkarkim nga detyra” dhe tani për llogari të formularit të vetëvlerësimit profesional. Në këto rrethana, i takon qartësisht e plotësisht që subjekti të jetë para “gjësë së gjykuar”.

6.4.2 Rivlerësimi profesional i Komisionit është kryer mbi qëndrimin e subjektit, ndërkohë që bazuar në legjislacionin përkatës kërkohet e kundërta, duhet qëndrimi i subjektit ndaj vlerësimit profesional të institucioneve të rivlerësimit. Me arsyetimin në vendim nuk mund të konsiderohet procesi i rivlerësimit për llogari të kontrollit të aftësive profesionale në përfundim të një hetimi administrativ, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Arsyetimi i vendimit të Komisionit është abuziv dhe alogjik, pasi nuk bazohet në relacionin e rivlerësimit sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, i cili nuk është përgatitur si i tillë nga relatorja e çështjes.

6.4.3 Nga katër dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti, është marrë në analizë vetëm një, në një kohë kur duhet të analizoheshin edhe tre të tjerat, pasi janë dokumente që shërbejnë për të provuar aftësitë profesionale të subjektit. Konkluzionet e Komisionit në lidhje me vendimin gjyqësor si dokument ligjor i përzgjedhur nga vetë subjekti, për sa i përket kohëzgjatjes së gjykimit të çështjes, janë të pabazuara.

6.4.4 Konkluzioni i KLD-së dhe i Komisionit në lidhje me dokumentet e përzgjedhura me short, për sa i përket kohëzgjatjes së gjykimit dhe veprimeve procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit të çështjeve, është i gabuar dhe abuziv.

6.4.5 Konkluzioni i Komisionit në lidhje me dokumentin nr. 2 të përzgjedhur me short, është i gabuar, pasi afati 5-ditor që përcakton Kodi i Procedurës Civile për gjykimin për lëshimin e urdhrat të ekzekutimit konsumohet deri te veprimet e regjistrimit në gjykatë, pa u paraqitur akoma çështja para gjyqtarit, prandaj jo më kot është hequr fare tashmë nga ligjvënësi. Duke zbritur kohën gjatë së cilës çështja e regjistruar ka qëndruar në pritje të gjykimit, gjykimi ka zgjatur për 7 ditë, në kohën më minimale të mundshme.

6.4.6 Për praktikën e procedimit disiplinor të vitit 2018, nuk është njoftuar për ndonjë procedim disiplinor ndaj tij dhe, për rrjedhojë, as për të drejtat që ka pasur në kuadër të këtij procedimi. Inspektorati i KLD-së ka kryer verifikim për gjëra që zgjidhen vetëm nëpërmjet apelimit gjyqësor. Ministri i Drejtësisë nuk mund të vlerësonte materialin e Inspektoratit të KLD-së nëse kishte vend apo jo për fillimin e procedimit disiplinor, sepse kjo nuk është parashikuar në tagrat e saj ligjore. Ministri i Drejtësisë në propozimin e masës disiplinore dhe Inspektorati KLD-së në raportin e tij kanë arritur në rezultatin se subjekti ka zvarritur gjykimet, në vlerësim të gabuar të veprimeve të tij në cilësinë e gjyqtarit.

6.4.7 Vlerësimet e Komisionit dhe të KLD-së, në lidhje me kriteret e vlerësimit profesional, janë abuzive, pasi arsyetimi për faktet që trajtojnë nuk referon gjëkund as në çështje dhe nuk analizon veprimet procedurale të kryera nga subjekti, duke mos cituar asnjë rast dhe asnjë koncept procedural.

6.4.8 Në dhënien e masës disiplinore, Komisioni ka arritur në një çmim jokushtetues, pasi në një qëndrim kushtetues, problematikat sipas arsytimit të Komisionit do të duhej të konsideroheshin mangësi profesionale dhe të zbatoheshin prezumimi në favor të masës disiplinore të pezullimit. Referenca ligjore të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 nuk parashikon asgjë për llogaritjen e arritjes së përfundimit “i papërshtatshëm” nga vlerësimi i aftësive profesionale, pasi ajo parashikon një nga kushtet për të dhënë masën, por nuk shpjegon arsyet e marrjes së masës disiplinore.

6.5 Në lidhje me denoncimin e publikut, subjekti ka pretenduar:

6.5.1 Arsyetimi dhe përfundimi i Komisionit në lidhje me denoncimin e paraqitur nga publiku për shkeljen e rregullave të etikës, nuk gjejnë vend në rezultatet e hetimit administrativ dhe, për rrjedhojë, nuk gjejnë vend as në shpjegimet e subjektit përkundër tyre. Subjekti nuk është njohur me CD-në e cituar në vendim dhe në këtë të fundit nuk trajtohet fare se çfarë konkretisht ka thënë subjekti, duke e vënë atë në pamundësi të japë argumente mbi sjelljet e tij të papërshtatshme. Arsyetimi i Komisionit është joligjor, pasi vlerësimi nuk është brenda periudhës së rivlerësimit, në zbatim të nenit 3, pika 12 për nenin 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

6.6 Në lidhje me vlerësimin tërësor të tri kriterëve, subjekti ka pretenduar:

6.6.1 Konkluzioni i Komisionit se subjekti ka cenuar besimin e publikut, është abuziv dhe joligjor, pasi ky përfundim nuk gjen vend në rezultatet e hetimit administrativ. Në vlerësimin tërësor të çështjes, Komisioni nuk referon provat, arsyet dhe dispozitat mbi të cilat mbështetet akti. Në një qëndrim ligjor kërkohet cenimi i besimit të publikut të sistemi i drejtësisë në një gjendje të tillë, që të jetë në kushtet pamundësisë për të plotësuar mangësitë nëpërmjet programit të trajnimit, ku jo më kot në parashikimin ligjor ligjvënësi ka përdorur lidhësen “dhe”, që nuk lë vend për tjetër interpretim.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit për shkaqet e ankimit me natyrë procedurale

7. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni nuk ka zbatuar procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe ka shkelur parimin e proporcionalitetit, pasi nuk e ka njoftuar për procedimin administrativ të zhvilluar ndaj tij. Bashkë me njoftimin për seancën dëgjimore, i ka bërë të ditur subjektit edhe të drejtën për të paraqitur dokumente me shkrim për vlerësimin e provave të administruara, rezultatet e hetimit dhe rezultatin e mundshëm të procedurës, në një kohë kur në rezultatet e hetimit administrativ nuk ka vlerësim për provat e administruara, nuk ka rezultate hetimi konkrete dhe nuk ka rezultate të mundshme të procedurës, në kundërshtim me parimin e objektivitetit, duke mos i dhënë mundësi subjektit të mbrohet në proces dhe as të dëgjohet përpara marrjes së vendimit përfundimtar. Komisioni ka shkelur parimet e përgjithshme mbi procedurën administrative, si: parimin e transparencës, informimit, dhënies së ndihmës aktive, ushtrimin të ligjshëm të diskrecionit, të drejtësisë dhe të paañsisë, si dhe të deburokratizimit dhe eficencës.*
8. Trupi gjykues i Kolegjit (në vijim “trupi gjykues”), nga tërësia e dokumentacionit të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, konstaton se me vendimin nr. 1, datë 24.01.2018, trupi gjykues i Komisionit ka deklaruar mospasjen e konfliktit të interesit me subjektin dhe ka vendosur fillimin e hetimit administrativ. Subjektit të rivlerësimit, më datë 07.06.2018, i është bërë e njohur nëpërmjet postës elektronike përbërja e trupit gjykues të Komisionit dhe gjatë gjithë procesit, subjekti nuk ka deklaruar të ketë konflikt interesi me anëtarët e këtij trupi gjykues. Gjatë zhvillimit të procesit të hetimit, Komisioni i ka kërkuar subjektit paraqitjen e shpjegimeve dhe provave në funksion të rrethanave dhe nevojave të këtij hetimi. Me vendimin nr. 2, datë 13.09.2018, Komisioni ka vendosur përfundimin e hetimit paraprak për subjektin e rivlerësimit dhe njoftimin e tij për kalimin e barrës së provës, për njohjen me provat e administruara nga Komisioni, si dhe për të drejtat e tij në lidhje me kërkimin e marrjes së provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve, vendim i cili i është njoftuar subjektit më datë 14.09.2018, nëpërmjet postës elektronike. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni për çdo rezultat është shprehur qartë se në cilat prova është bazuar, duke i cituar ato, përfshirë edhe ato të paraqitura nga subjekti deri në këtë fazë të hetimit. Për çdo gjetje, rezultatet e hetimit përmbajnë analizën e provave dhe analizën financiare, kur është rasti. Subjekti ka ushtruar të drejtën e tij për njohjen dhe marrjen e dokumentacionit të dosjeve të hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij², në formë fizike dhe elektronike dhe, më datë 24.09.2018, ka dërguar në Komision shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, si dhe dokumentacionin që ai e ka konsideruar të nevojshëm për të mbështetur pretendimet e tij për secilin prej kritereve të vlerësimit, bazuar në konstatimet e bëra nga Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ. Me vendimin nr. 3, datë 25.09.2018, Komisioni ka vendosur të ftojë subjektin në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.
9. Në seancën dëgjimore të datës 03.10.2018, subjekti ka deklaruar se ka marrë të gjitha dokumentet, pjesë përbërëse e dosjes së tij të rivlerësimit. Në vazhdim të seancës dëgjimore, subjekti nuk ka kundërshtuar elemente procedurale të procedurës së hetimit të zhvilluar ndaj tij, apo elemente procedurale të lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore. Pra, në kundërshtim me sa pretendon, subjekti është njoftuar për hetimin administrativ të zhvilluar ndaj tij. Subjektit i janë garantuar e drejta e njohjes me të gjitha aktet e hetimit administrativ dhe e kundërshtimit

² Këtë të drejtë subjekti e ka ushtruar edhe në Kolegj. Më datë 15.03.2019, subjekti është njohur me dosjen gjyqësore, duke kërkuar vënien në dispozicion të disa akteve të saj. Më datë 17.04.2019, subjektit i janë vënë në dispozicion fotokopje të akteve të kërkuara prej tij, pjesë e dosjes gjyqësore.

të tyre, e drejta e paraqitjes së provave, e drejta e mbrojtjes, e drejta e dëgjimit në seancë publike.

10. Bazuar në situatën faktike si më sipër, Kolegji vlerëson se rezultatet e hetimit të Komisionit kanë qenë konkrete, lehtësisht të dallueshme edhe nga pikëpamja formale, të shoqëruara me citimin e provave ku bazohen, porë këto në lidhje të ngushtë me dosjen e hetimit dhe me faktin se kjo dosje i është vënë në dispozicion subjektit dhe ai është njohur me të. Subjekti ka paraqitur shpjegimet e konsideruara të nevojshme prej tij dhe gjatë seancës dëgjimore nuk ka paraqitur pretendime për mosnjohje të rezultateve të hetimit dhe, për pasojë, për pamundësi mbrojtjeje efektive. Nga verifikimi i hapave proceduralë të ndjekur nga Komisioni, siç u përshkruan më sipër, rezulton e provuar se subjektit i janë garantuar të gjitha të drejtat procedurale, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 84/2016.

Sa më sipër, Kolegji arrin në konkluzionin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

11. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se në procesin e zhvilluar nga Komisioni është bërë një hetim i thelluar, por në fakt hetimi nuk thotë asnjë fjalë të vetme për hetimin shtesë dhe, në këto rrethana, të dhënat që dalin nga hetimi nuk dihet se ku bazohen, nëse bazohen në hetimin e subjekteve apo bazohen në hetimin e Komisionit. Hetimi nuk është bazuar në asnjë lloj prove që ka rezultuar nga hetimi i thelluar, por është bazuar në raportet e organeve të tjera.*

Në lidhje me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues i Kolegjit, nga verifikimi i akteve të administruara gjatë hetimit në Komision, konstaton se në përputhje me ligjin nr. 84/2016, Komisioni ka hetuar duke kryer të gjithë hapat proceduralë të nevojshëm, duke iu drejtuar subjekteve publike dhe private për të mbledhur informacionin e duhur, si dhe duke komunikuar me subjektin e rivlerësimit për t'i kërkuar shpjegime dhe prova për rrethana të ndryshme të paraqitura gjatë hetimit. Subjekti ka paraqitur shpjegime dhe prova nëpërmjet postës elektronike, në datat 27 korrik 2018; 2, 4, 13, 14 dhe 15 gusht 2018.

Në rezultatet e hetimit administrativ, dërguar subjektit më datë 13.09.2018, Komisioni i ka bërë të njohur se rezultati është bazuar në deklaratimet e bëra nga ai pranë ILDKPKI-së; provat shkresore të administruara nga ana e ILDKPKI-së; analizën e konstatimeve të ILDKPKI-së; raportin e DSIK-së; raportin e KLD-së; dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti; deklaratimet e bëra nga ai, personat e lidhur dhe personat e tjerë të lidhur me të, gjatë hetimit administrativ; provat shkresore të administruara nga institucionet publike dhe private, si dhe në analizën financiare të bërë nga ana e Komisionit.

12. Trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në rrethanat faktike si më sipër, vlerëson se hetimi i kryer nga Komisioni nuk është hetim shtesë, por është hetimi i kryer prej tij bazuar në nenet 45, 49 e 50 të ligjit nr. 84/2016. Edhe në vendim, Komisioni ka pasqyruar veprimet hetimore të kryera për secilin nga kriteret e rivlerësimit, si dhe i është referuar qëndrimit të subjektit në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, në arsyetimin e ndjekur në funksion të arritjes së konkluzioneve përfundimtare.

Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

13. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se në seancë dëgjimore, Komisioni trajtoi prova të reja të cilat nuk ia bëri me dije seancës dhe as ia vuri atij në dispozicion, duke i shkelur të drejtat në proces. Në seancë dëgjimore, subjekti nuk dha shpjegime të hollësishme, pasi iu kufizua mundësia për t'u shprehur e megjithatë shpjegimet e subjektit nuk u kundërshtuan nga Komisioni, që do të thotë se ato qëndrojnë sipas versionit të shpjeguar prej tij.*

Trupi gjykues i Kolegjit, nga verifikimi i procesverbalit të seancës dëgjimore të zhvilluar në Komision më datë 03.10.2018, konstaton se relatorja e çështjes ka prezantuar përmbajtjen e dosjes së subjektit të rivlerësimit, si dhe çfarë ka rezultuar nga hetimi administrativ. Gjatë këtij

relatimi, ajo ka cituar provat mbi të cilat janë bazuar rezultatet e hetimit, për të cilat subjekti nuk ka paraqitur ndonjë pretendim për mosnjohje me to. Pas dhënies së shpjegimeve nga subjekti, relatorja i ka drejtuar atij pyetje në lidhje me të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e tij, nga aktiviteti si notere publike. Relatorja e çështjes, në sqarim të rrethanave dhe fakteve të rezultuara nga hetimi, ka cituar formularët e deklaramentit për qarkullimin vjetor nga aktiviteti si notere e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, të dorëzuara nga subjekti në Komision gjatë hetimit administrativ. Në vazhdim të seancës dëgjimore, si dhe në qëndrimin e tij përfundimtar për procesin e rivlerësimit, subjekti nuk ka kërkuar të njihet me ndonjë akt të përmendur nga relatorja në seancë dëgjimore, të cilin e ka pretenduar në ankim. Kolegji konstaton se pas përcjelljes të subjektit të rezultateve të hetimit administrativ, Komisioni nuk ka administruar prova nga institucione publike apo private, me përjashtim të provave të paraqitura nga vetë subjekti më datë 24.09.2018, bashkëlidhur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ, dhe më datë 01.10.2018, para zhvillimit të seancës dëgjimore.

14. Lidhur me pretendimin e subjektit se në seancë dëgjimore nuk dha shpjegime të hollësishme, pasi iu kufizua mundësia për t'u shprehur, trupi gjykues i Kolegjit, nga verifikimi i procesverbalit të seancës dëgjimore të datës 03.10.2018, konstaton se subjekti e ka marrë fjalën menjëherë pas prezantimit të përmbajtjes së dosjes së hetimit administrativ nga relatorja e çështjes, duke parashtruar me hollësi të gjitha pretendimet e tij, të njëjta me ato të paraqitura në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ. Për shkak të këtij prezantimi të detajuar të pretendimeve të tij, në kushtet kur Komisioni ishte njohur me këto shpjegime paraprakisht, si dhe në mbështetje të nenit 55, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, kryesuesja e trupit gjykues i ka kërkuar disa herë subjektit që të përmbledhte deklaramentet e tij. Megjithatë, subjekti ka vijuar me shpjegimet, duke i paraqitur ato në mënyrë të plotë. Në përfundim të seancës, përpara se trupi gjykues të tërhiqej për vendim, subjekti ka ushtruar të drejtën e tij për të dhënë qëndrimin përfundimtar në lidhje me procesin e rivlerësimit të zhvilluar ndaj tij. Bazuar në këto rrethana faktike, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk është kufizuar në të drejtën e tij për t'u shprehur në seancë dëgjimore.
15. Lidhur me pretendimin e subjektit se meqenëse shpjegimet e tij nuk u kundërshtuan nga Komisioni në seancë dëgjimore, do të thotë se ato qëndrojnë sipas versionit të shpjeguar prej tij, trupi gjykues konstaton se në seancën dëgjimore, relatorja e çështjes është shprehur se shpjegimet e dhëna nga subjekti do të vlerësohen nga trupi gjykues i Komisionit para marrjes së vendimit përfundimtar. Trupi gjykues çmon se gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, Komisioni nuk mund të vlerësojë provat apo qëndrimet e subjektit, pasi në përputhje me nenin 55, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ky vlerësim bëhet gjatë bisedimeve për marrjen e vendimit e më pas shprehet në vendimin përfundimtar.
Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.
16. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vendimi i Komisionit nuk ka formën ligjore, nuk përmban asnjë nga elementet e përcaktuara në nenin 57, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, duke qenë në kundërshtim flagrant me ligjin dhe, si i tillë, nuk mund të prodhojë pasoja ligjore. Vendimi nuk i është njoftuar subjektit konform kërkesave ligjore, pasi brenda afatit ligjor nuk ka vendim të shkruar, brenda këtij afati nuk ka as njoftim të këtij vendimi dhe, për rrjedhojë, për masën disiplinore shkarkim nga detyra nuk ka vendim dhe, vetëm për këto rrethana, subjekti kërkon konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të Komisionit. Vendimi është në shmangie të plotë të arsytimit të rezultateve të hetimit administrativ dhe të pretendimeve të subjektit për to, të përmbajtjes së akteve dhe të seancës dëgjimore, si dhe nuk shpjegon arsyet për këto shmangie.*

17. Trupi gjykues i Kolegjit, nga verifikimi i vendimit të Komisionit, konstaton se ai përmban bazën ligjore mbi të cilën bazohet procesi i rivlerësimit, analizën e provave të administruara, vlerësimin e Komisionit në lidhje me hetimin administrativ ndaj subjektit të rivlerësimit, si dhe caktimin e masës disiplinore. Në vendim është bërë një analizë e plotë e provave, të cilat janë përdorur për vlerësimin e tri kriterëve të rivlerësimit. Për secilin kriter të hetuar, janë marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit dhe janë reflektuar prapësimet e tij në lidhje me disa elemente të vlerësimit të tyre. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se vendimi i Komisionit është në përputhje të plotë me nenin 57 të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, trupi gjykues vlerëson se vendimi i Komisionit përmban të gjitha elementet thelbësore të një vendimi, në përputhje edhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese³ dhe atë të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut⁴. Bazuar në këto jurisprudenca, arsyetimi i vendimit të Komisionit është i plotë, duke u dhënë përgjigje pretendimeve të subjektit, gjatë procesit të rivlerësimit të kryer ndaj tij.
18. Në lidhje me pretendimin e subjektit se vendimi nuk i është njoftuar konform kërkesave ligjore, pasi brenda afatit ligjor nuk ka vendim të shkruar, brenda këtij afati nuk ka as njoftim të këtij vendimi dhe, për rrjedhojë, për masën disiplinore shkarkim nga detyra nuk ka vendim, trupi gjykues i Kolegjit, nga verifikimi i akteve të hetimit administrativ, konstaton se Komisioni me shkresën nr. {***} prot., datë 02.11.2018, i ka njoftuar subjektit vendimin nr. 67, datë 05.10.2018, dhe ai e ka marrë njoftimin nëpërmjet shërbimit postar, më datë 09.11.2018. Njohjen me vendimin, subjekti e pranon edhe në ankim. Në përgjigje të pretendimit të subjektit, në raport me rrethanat faktike si më sipër, trupi gjykues vlerëson se ligji nr. 84/2016, në nenin 55, pika 7 përcakton se vendimi me shkrim i Komisionit i njoftohet subjektit të rivlerësimit brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore. Në rastin konkret, kjo dispozitë është zbatuar me përpikëri nga Komisioni, pasi vendimi është shpallur në seancë dëgjimore më datë 05.10.2018, ndërsa vendimi i arsyetuar me shkrim i është bërë i njohur subjektit më datë 02.11.2018.
19. Në lidhje me pretendimin e subjektit se vendimi është në shmangie të plotë të arsyetimit të rezultateve të hetimit administrativ dhe pretendimeve të subjektit për to, të përmbajtjes së akteve dhe të seancës dëgjimore, si dhe nuk shpjegon arsyet për këto shmangie, trupi gjykues i Kolegjit, nga verifikimi i përmbajtjes së vendimit të Komisionit, konstaton se në raport me përmbajtjen e rezultateve të hetimit administrativ, në vendim gjejnë trajtim çështjet e ngritura në hetim; paraqitet qëndrimi i subjektit për to, i dhënë në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit dhe në seancë dëgjimore; paraqitet arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm dhe, në përfundim, paraqiten konkluzionet e Komisionit për secilin kriter vlerësimi. Trupi gjykues i Kolegjit çmon se vlerësimi i provave bëhet nga Komisioni në vendimin përfundimtar, pas kryerjes së hetimit administrativ dhe pas dhënies së shpjegimeve përfundimtare të subjektit në seancë dëgjimore. Ky vlerësim i provave, i ndryshëm nga vlerësimi që iu bën atyre vetë subjekti, nuk do të thotë shmangie e Komisionit nga rezultatet e hetimit administrativ. Edhe ndonjë ndryshim i disa elementeve në analizën e vlerësimit të tri kriterëve, i ardhur si pasojë e reflektimit të Komisionit pas shpjegimeve të dhëna nga vetë subjekti, nuk mund të konsiderohet si shmangie nga rezultatet e hetimit.
- Për sa më sipër, Kolegji arrin në konkluzionin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.***
20. *Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar që Kolegji ta shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore me praninë e tij, duke i dhënë mundësi të dëgjohet e të mbrohet, në funksion të konstatimit të drejtë*

³ Vendimi nr. 12, datë 19.3.2015 dhe vendimi nr. 26, datë 27.3.2017 të Gjykatës Kushtetuese.

⁴ GjEDNj në çështjen Garcia Ruiz v. Spain, 1999 është shprehur se neni 6/1 i KEDNj i detyron gjykatat të japin vendime të arsyetuara, por kjo nuk duhet të kuptohet si detyrim për të dhënë përgjigje të detajuara për çdo argument.

të gjendjes faktike, por edhe sepse vendimi i Komisionit është i pavlefshëm, i marrë në kundërshtim me parimet e përgjithshme të procedurës administrative.

Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, Kolegji konstaton se subjekti i rivlerësimit, në faqen e fundit të ankimit, ka cituar një listë provash, por bashkëlidhur ankimit nuk ka paraqitur akte. Subjekti, pas marrjes së njoftimit për gjykimin e çështjes në dhomë këshillimi, ka paraqitur parashtrimet me shkrim në Kolegji, në datat 01.11.2019 dhe 04.11.2019, 5 ditë para seancës gjyqësore, bashkëlidhur të cilave ka paraqitur akte shkresore. Këto akte, trupi gjykues vendosi të mos i pranojë, pasi vlerëson se bazuar në nenin 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 në këtë fazë të procesit, palët mund të paraqesin vetëm parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, por jo fakte dhe prova të reja.

Në mbështetje të parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, debati gjyqësor në seancë gjyqësore, me praninë e subjektit, është i panevojshëm, pasi: a) konstatimi i gjendjes faktike është bërë nga Komisioni në mënyrë të plotë dhe të saktë dhe, për pasojë, nuk nevojitet vërtetimi i fakteve të reja dhe marrja e prova të reja; b) nuk konstatohen shkelje të rënda procedurale që të kenë ndikuar në vendimmarrje, apo gjendje faktike të konstatuara gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga Komisioni. Hetimi gjyqësor ka qenë i rregullt, vendimmarrja e Komisionit ka qenë në përputhje të plotë me parimet e procesit të rregull ligjor, duke i garantuar subjektit të gjitha të drejtat e parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 dhe nuk ka shkaqe për pavlefshmëri të tij; c) nuk vlerësohet se është nevojshme përsëritja e marrjes së disa apo të gjitha provave të marra në Komision.

Për këtë arsye, trupi gjykues vlerëson se nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e subjektit të rivlerësimit. Shqyrtimi i ankimit të subjektit të rivlerësimit u zhvillua në dhomë këshillimi, në bazë dokumentesh.

Për sa më sipër, Kolegji arrin në konkluzionin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe shkaqet e ankimit lidhur me të

21. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se për llogari të kontrollit të pasurisë është e treta herë që i nënshtrohet kontrollit, fillimisht në vitin 2009, më pas në vitin 2014 dhe tashmë për llogari të deklaratës së pasurisë së rivlerësimit. Për gjërat që ka kontrolluar Komisioni, në substancën e tyre dhe për më tepër në këndvështrimin që i ka parë, i takon qartësisht e plotësisht që subjekti të jetë para “gjësë së gjykuar”.*

Në analizë të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues vlerëson se kontrolli i pasurisë së subjektit për efekt të procesit të rivlerësimit, bazohet në përcaktimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ato të ligjit nr. 84/2016. Subjekti, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, dorëzon një deklaratë të re pasurie, e cila përfshin deklarimin e të gjitha pasurive të akumuluar ndër vite deri në datën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë së rivlerësimit. Bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja kryen një procedurë të plotë kontrolli dhe përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, me konstatimet përkatëse, të cilin ia përcjell Komisionit. Ligji nr. 84/2016, kontrollin e deklaratës së pasurisë së rivlerësimit e ka çmuar si një kontroll të ri, duke u njohur vlerën e provës deklarative periodike të pasurisë së subjektit në vite, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 5. Në procesin e rivlerësimit, ILDKPKI-ja është një organ ndihmës, në mbështetje të organeve të rivlerësimit, në ushtrimin e funksioneve të tyre kushtetuese dhe në përmbushjen e misionit të tyre⁵. Procesi i rivlerësimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë autorizohet nga ligji i posaçëm nr. 84/2016, me një metodologji dhe procedurë të posaçme, me qëllim dhe funksion të përcaktuar dhe të ndryshëm nga ligji nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe

⁵ *Vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese.*

kontrollin e pasurive”. Rivlerësimi për shkak të ligjit nr. 84/2016, aplikohet dhe kryhet vetëm një herë dhe vendimmarrja u përket organeve të rivlerësimit. Në këto kushte, procesi i rivlerësimit për kriterin e pasurisë, për subjektin, nuk gjendet në kushtet e zbatimit të parimit të “gjësë së gjykuar”.

Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit është i pabazuar.

22. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit se nuk ka burime të mjaftueshme financiare për blerjen e automjetit në vitin 2005 nuk qëndron, pasi Komisioni në analizën financiare nuk ka përllogaritur saktë shpenzimet e jetesës për këtë vit, në kundërshtim me sa ka shpjeguar dhe pretenduar subjekti gjatë hetimit administrativ. Dyshimi i Komisionit për shkëmbimin e automjetit në pronësi të subjektit me një automjet rreth dy herë më të shtrenjtë, në vitin 2012 pa kundërshtim, është i pabazuar në prova.*

Trupi gjykues i Kolegjit, nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni, për pasurinë automjet “Mercedes Benz” me targë {***} në pronësi të subjektit të rivlerësimit, konstaton situatën faktike si më poshtë.

23. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar pronësinë e automjetit “Mercedes Benz” me targë {***}, si rezultat i shkëmbimit me automjetin që ka pasur më parë, shkëmbim i kryer me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.09.2012. Të njëjtin deklaram, subjekti e ka kryer edhe në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2012.

Sipas kontratës së shkëmbimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.09.2012, subjekti ka pasur në pronësi një automjet “Mercedes Benz”, vit prodhimi 1995, të cilin e ka shkëmbyer me automjetin “Mercedes Benz”, vit prodhimi 2003, në pronësi të z. S.M. Ky shkëmbim është bërë pa asnjë kundërshtim.

Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor, me shkresat nr. {***} prot., datë 12.02.2018 dhe nr. {***} prot., datë 21.02.2018, ka përcjellë në Komision informacion mbi dosjen e automjetit “Mercedes Benz”, vit prodhimi 1995, sipas të dhënave të së cilës subjekti e ka blerë këtë automjet me anë të kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol, datë 07.11.2005, në vlerën 300.000 lekë. Subjekti në ankim ka pranuar faktin se mbi çmimin e kontratës, ka paguar shtesë dhe detyrimet doganore për automjetin. Bazuar në faturën doganore të Doganës Bllatë, datë 08.11.2005, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e importuesit, ka paguar detyrimin doganor për automjetin “Mercedes Benz”, vit prodhimi 1995, në vlerën 267.401 lekë. Sipas urdhërshirimit të jashtëm të lëshuar nga Banka e Kursimeve, datë 08.11.2005, rezulton se subjekti ka paguar detyrimin doganor dhe komisionet bankare në vlerën totale prej 268.203 lekësh⁶. Për rrjedhojë, vlera e automjetit tip “Mercedes Benz”, vit prodhimi 1995, në ish-pronësi të subjektit, pas pagimit të detyrimeve dhe çmimit të kontratës, është 568.203 lekë.

24. Komisioni, në vendim⁷, pas kryerjes së analizës financiare, ka arritur në konkluzionin se subjekti gjendet në situatën e mungesës së burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit, si edhe për shpenzimet e kryera gjatë vitit 2005, në shumën 93.056 lekë. Në ankim, subjekti kundërshton analizën e Komisionit për vlerën e shpenzimeve të jetesës, të cilat sipas tij duhet të ishin 713.614 lekë dhe jo 803.571 lekë, sa ka përllogaritur Komisioni. Lidhur me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues, i ndihmuar nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Kolegjit, konstaton se shpenzimet mesatare të jetesës për një familje me 5 persona në vitin 2005, sipas ILDKPKI-së, bazuar në INSTAT, janë në vlerën 547.785 lekë. Duke qenë se vetë subjekti ka pranuar se shpenzimet e jetesës së familjes së tij në vitin 2005 kanë qenë në vlerën 713.614 lekë, pra mbi nivelin mesatar, trupi gjykues arrin në konkluzionin se Komisioni, në analizën financiare për vitin 2005, duhet të kishte konsideruar këtë vlerë shpenzimesh, të deklaruar nga

⁶ Ky informacion është pjesë e të dhënave të dosjes së automjetit “Mercedes Benz”, vit prodhimi 1995, përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor.

⁷ Shih faqet 6 -7 të vendimit nr. 67, datë 05.10.2018, të Komisionit.

vetë subjekti. Gjithashtu, trupi gjykues vlerëson se gjatë hetimit ka rezultuar e provuar se subjekti, shpenzimet në vlerën 568.203 lekë për blerjen e automjetit “Mercedes Benz”, vit prodhimi 1995, i ka kryer deri më datë 08.11.2005. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se Komisioni, analizën financiare për përllogaritjen e burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit, duhet ta kryente duke përllogaritur të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit për periudhën 01.01.2005 deri më datë 08.11.2005.

25. Trupi gjykues shqyrtoi mjaftueshmërinë e burimeve financiare të subjektit për blerjen e automjetit “Mercedes Benz”, vit prodhimi 1995. Si rezultat i analizës financiare, trupi gjykues vlerëson se mungesa e burimeve të ligjshme financiare të subjektit për blerjen e automjetit “Mercedes Benz”, konfirmohet në vlerën e përllogaritur nga Komisioni, por nëse kjo analizë do të kryhej bazuar në arsyetimin e bërë më sipër⁸, mungesa e burimeve të ligjshme financiare të subjektit për blerjen e automjetit, do të kishte një vlerë më të lartë sesa ajo e konkluduar nga Komisioni, në vendim. Në këto kushte, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti ka kryer deklaram të pamjaftueshëm, bazuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
26. Në ankim, subjekti pretendon se dyshimi i Komisionit për shkëmbimin e automjetit “Mercedes Benz”, vit prodhimi 1995 me një automjet “Mercedes Benz”, vit prodhimi 2003, sipas kontratës së shkëmbimit të datës 05.09.2012, nuk qëndron, pasi: a) ky dyshim nuk është shprehur në rezultatet e hetimit administrativ dhe, për rrjedhojë, subjekti nuk ka dhënë shpjegime për të; b) për kohën dhe vlerën e blerjes së automjetit në Itali nga pronari që ka pasur mjetin, nuk ka asnjë akt/provë, pasi mjeti ka ardhur në Shqipëri i regjistruar në emrin e pronarit që në Itali; c) të dhënat e cituara nga Komisioni nuk janë data dhe vlera e saktë e blerjes së mjetit në Itali, por janë data e zhdoganimit dhe referenca që ka vendosur dogana, pa pasur akte provuese. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, trupi gjykues i Kolegjit, nga verifikimi i akteve të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, konstaton se sipas informacionit të përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor, automjetin “Mercedes Benz”, vit prodhimi 2003, objekt shkëmbimi i kontratës së datës 05.09.2012, pala kontraktore, z. S.M., e ka blerë nga djali i tij, z. R.M., në vlerën 100.000 lekë, sipas kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.12.2011. Sipas dokumentacionit doganor të Doganës Bllatë, z. R.M. këtë automjet e ka sjellë në Shqipëri nga Italia, më datë 17.12.2011, kurse vlera e automjetit është 7.040 euro dhe detyrimi doganor është në vlerën 198.849 lekë. Bazuar në lejen e qarkullimit të automjetit në shtetin italian, z. R.M. është bërë pronar i këtij mjeti në datën 29.07.2011. Pavarësisht këtyre rrethanave faktike, të cilat rezultojnë të njëjta me ato të pretenduara nga subjekti në ankim, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në vendim, ka mbetur në nivelin e dyshimeve, pa e ngarkuar subjektin me përgjegjësi disiplinore.
27. Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme financiare për blerjen e automjetit “Mercedes Benz” në vitin 2005, siç përcaktohet në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit është i pabazuar.

28. *Subjekti ka pretenduar se në kundërshtim me sa ka konkluduar Komisioni, në ILDKPKI dhe në organet tatimore për vitet 2006 dhe 2007 ka paraqitur jo vetëm aktet financiare me parregullsi, por edhe aktet financiare të sistemuara. Pasqyrat financiare për vitet 2006 dhe 2007, të cilave iu referohet Komisioni, nuk kanë vlerë juridike përballë deklaratave të qarkullimit vjetor të realizuar, të paraqitura pranë Bashkisë së Peshkopisë, sot Dibër. Komisioni, në analizën financiare për periudhën 2005-2012, ka trajtuar gabim të ardhurat nga biznesi i bashkëshortes së tij për vitet 2006 dhe 2007, si dhe nuk ka konsideruar pagën e saj si notere në asnjë vit.*

⁸ Shih paragrafin 24 të këtij vendimi.

Në lidhje me këtë shkak ankimi, trupi gjykues, nga aktet e administruara gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, konstaton se në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar të ardhura nga aktiviteti privat i bashkëshortes si noter publik për periudhën 14.09.2006 - 31.12.2016, në vlerën 8.510.969 lekë. Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka paraqitur pasqyrat financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve të aktivitetit të bashkëshortes për periudhën 2006-2016. Pasqyrat financiare të viteve 2006, 2007 dhe 2008 mbajnë numër protokolli {***}, datë 31.03.2009 dhe vulën e Drejtorisë Rajonale Tatimore, Dibër. Nga të dhënat e pasqyrave të sipërcituara, fitimi i aktivitetit të bashkëshortes së subjektit ka qenë për vitin 2006 në vlerën 150.369 lekë dhe për vitin 2007 në vlerën 450.406 lekë.

29. Nga hetimi i kryer nga ILDKPKI-ja, gjatë kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, rezultojnë se:
- a) Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër, në informacionin e përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 07.07.2017, konfirmon të njëjtat vlera për vitet 2006 dhe 2007, për sa i përket fitimit të realizuar nga personi fizik M.J., me NIPT {***};
 - b) Bashkia Dibër, me shkresën nr. {***} prot., datë 11.07.2017, informon ILDKPKI-në për të dhënat në lidhje me qarkullimin vjetor dhe pagesën e taksave dhe tarifave vendore, që i përkasin personit fizik M.J., me {***}. Në këtë informacion nuk janë pasqyruar të dhëna për vitin 2006, ndërsa për vitin 2007 nuk janë pasqyruar të dhëna për qarkullimin vjetor, por vetëm për pagesën e taksave dhe tarifave vendore, në vlerën 36.500 lekë. Bashkia Dibër nuk ka dhënë informacion në lidhje me fitimin e realizuar nga znj. M.J. nga aktiviteti si notere publike.
30. Në ankim, subjekti, në mbështetje të pretendimit të tij, ka dhënë shpjegime të njëjta me ato të paraqitura gjatë hetimit në Komision, në përgjigje të barrës së provës për konstatimin e Komisionit se deklarimi i tij për fitimin nga aktiviteti privat i noterisë së bashkëshortes, nuk përputhet me dokumentacionin e administruar në bazë të përgjigjeve të ardhura nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër. Për të mbështetur këto pretendime, subjekti, bashkëlidhur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ, ka paraqitur në Komision:
- a) “Deklaratë e qarkullimit vjetor për vitin 2006”, Bashkia Peshkopi, deklaruese M.J., qarkullimi vjetor 1.000.000 lekë, fitimi vjetor 544.158 lekë. Bashkëlidhur “Pasqyra financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2006”;
 - b) “Deklaratë e qarkullimit vjetor për vitin 2007”, Bashkia Peshkopi, deklaruese M.J., qarkullimi vjetor 3.000.000 lekë, fitimi vjetor 1.725.575 lekë. Bashkëlidhur “Pasqyra financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2007”;
 - c) “Deklaratë e qarkullimit vjetor për vitin 2008”, Bashkia Peshkopi, deklaruese M.J., qarkullimi vjetor 3.700.000 lekë, fitimi vjetor 1.155.488 lekë. Bashkëlidhur “Pasqyra financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2008”.
- Deklaratat janë nënshkruar nga deklaruesja znj. M.J. dhe mbajnë vulën e Bashkisë Peshkopi.
31. Në analizë të pretendimit të subjektit, mbështetur në situatën faktike si më sipër, trupi gjykues vlerëson se pasqyrat financiare për vitet 2006 dhe 2007, të depozituara nga subjekti në ILDKPKI si dokumentacion justifikues bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, mbajnë datë dhe numër protokolli, si dhe vulën e institucionit të tatimeve, elemente këto që provojnë se ky dokumentacion është dokumentacion zyrtar i lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër. Deklaratat e qarkullimit vjetor për vitet 2006 dhe 2007, të shoqëruara me të ardhurat dhe shpenzimet për këto vite, të depozituara pranë Bashkisë Peshkopi nga bashkëshortja e subjektit dhe që ky i fundit i ka paraqitur pranë Komisionit gjatë hetimit administrativ⁹, pasqyrojnë një fitim rreth tri herë më të madh për secilin vit, krahasuar me të dhënat e fitimit sipas pasqyrave financiare të depozituara nga subjekti në ILDKPKI. Pra,

⁹ Bashkëlidhur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ.

subjekti për efekt të procesit të rivlerësimit ka dorëzuar dy pasqyra financiare për vitet 2006 dhe 2007 të aktivitetit të bashkëshortes së tij si notere publike, të cilat pasqyrojnë fitime të ndryshme për të njëjtin vit.

Të dhënat e pasqyrave financiare të depozituara nga subjekti në ILDKPKI, bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, lidhur me xhiron dhe fitimin e deklaruar nga bashkëshortja e subjektit, përputhen plotësisht me të dhënat e përcjella në ILDKPKI nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër, me shkresën nr. {***} prot., datë 07.07.2017.

32. Subjekti pretendon se pranë organeve tatimore ka dorëzuar aktet financiare të parregulluara dhe aktet e sistemuara, por organi tatimor ka përcjellë të dhëna bazuar në aktet financiare të parregulluara. Trupi gjykues vlerëson se ky pretendim i subjektit nuk qëndron, pasi ai nuk mund të kryente sistemime në vitin 2009 për deklaratat tatimore të viteve 2006 dhe 2007. Këtë konkluzion, trupi gjykues e bazon në nenin 67, pikat 1 dhe 2 të ligjit të kohës, nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit tatimpaguesi mund të dorëzonte deklaratë të re tatimore, me ndryshime, në rastet kur deklarata tatimore fillestare ishte e pasaktë dhe me mangësi. Deklarata e ndryshuar mund të dorëzohej brenda dymbëdhjetë muajve nga afati i dorëzimit të deklaratës fillestare. Përcaktimet e këtij ligji ishin të detyrueshme edhe për bashkitë dhe komunat, në lidhje me të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre fiskale për taksat vendore, bazuar në nenin 4 të ligjit të kohës nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”. Subjekti nuk ka paraqitur asnjë provë në mbështetje të pretendimit të tij se ka kryer sistemime të deklaratave tatimore për vitet 2006 dhe 2007. Deklaratat e qarkullimit vjetor për vitet 2006 dhe 2007, të paraqitura nga subjekti gjatë hetimit administrativ, mbajnë vulën e Bashkisë Peshkopi dhe janë vetëdeklarime të subjektit tatimpagues, të dorëzuara përkatësisht për vitin 2006, më datë 20.03.2007, dhe në vitin 2007, më datë 19.03.2008. Trupi gjykues vlerëson se këto deklarime nuk janë korrigjime apo sistemime të ndonjë deklarate të mëparshme.
33. Subjekti pretendon se pasqyrat financiare për vitet 2006 dhe 2007, të dorëzuara prej tij në ILDKPKI, me deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, nuk kanë vlerë juridike përballë deklaratave të qarkullimit vjetor për vitet 2006 dhe 2007, të dorëzuara nga bashkëshortja pranë Bashkisë së Peshkopisë (sot Dibër), pasi detyrimi tatimor nuk lidhet me fitimin vjetor të realizuar, por me qarkullimin vjetor. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues vlerëson se bazuar në ligjin e kohës nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i cili ka hyrë në fuqi më datë 1 janar 2007 dhe udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 655/1, datë 6.2.2007, “Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore”, taksa vendore mbi biznesin e vogël/tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël ka qenë një taksë vendore e cila paguhej sipas kësteve të përcaktuara nga zyra e taksave në bashki apo në komunë, në çdo degë banke dhe në çdo zyrë postare në territorin e bashkisë apo të komunës, ose në arkën e vetë bashkisë apo të komunës përkatëse. Pra, për vitin 2007, deklarimi i qarkullimit vjetor dhe pagimi i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin bëhej pranë Bashkisë Peshkopi. Për vitin 2007, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar qarkullim vjetor në vlerën 3.000.000 lekë dhe për vitin 2006, 1.000.000 lekë, sipas deklaratave të qarkullimit vjetor për vitin 2007 dhe vitin 2006, të dorëzuara pranë Bashkisë Peshkopi (sot Dibër). Nga hetimi administrativ i Komisionit, ka rezultuar se Bashkia Dibër për personin fizik M.J., për vitin 2007 nuk ka përcjellë të dhëna për qarkullim vjetor, por vetëm pagesë për taksat dhe tarifatat vendore, ndërsa për vitin 2006 nuk jep asnjë të dhënë. Bashkia Dibër nuk konfirmon të njëjtat të dhëna me deklarimin e subjektit për sa i përket vlerës së qarkullimit vjetor të aktivitetit të noterisë së bashkëshortes së tij, ndërsa nuk jep të dhëna për sa i përket fitimit të realizuar prej saj. Trupi gjykues vlerëson se bazuar në nenin 29, pika 4 e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar¹⁰, dhe udhëzimit të Ministrisë së Financave

¹⁰ Me ligjin nr. 179/2013, datë 28.12.2013.

nr. 32, datë 31.12.2013, “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është organi i cili mban sistemin qendror të të dhënave për secilin tatimpagues, duke përfshirë edhe të dhënat për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, që i janë përcjellë nga njësitë e qeverisjes vendore brenda datës 30 janar 2014, pra edhe nga Bashkia Dibër dhe për vitet 2006 e 2007. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se në kundërshtim me sa pretendon subjekti, të dhënat e paraqitura nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër kanë vlerë juridike, pasi ato janë të dhënat e paraqitura nga organi shtetëror kompetent për tatimet, ndërsa të dhënat e pretenduara nga ai për fitimin e realizuar nga bashkëshortja e tij për vitet 2006 dhe 2007, sipas deklaratave të qarkullimit vjetor të dorëzuara në Bashkinë Peshkopi, nuk u vërtetuan prej tij me asnjë dokument zyrtar, përkundrazi, të dhënat e dokumenteve zyrtare dëshmojnë të kundërtën.

34. Subjekti pretendon se në të dhënat e pasqyruara nga organet tatimore ka kontradiktë të pastër, pasi në shkresën e datës 22.02.2018 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër rezulton se nuk ka pasqyra financiare të dorëzuara, duke rënë ndesh me shkresën e mëparshme të datës 07.07.2017, që trajton se i bazon të dhënat në pasqyrat financiare të dorëzuara.

Nga verifikimi i shkresave të cituara nga subjekti, të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues konstaton se Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër, në shkresën nr. {***} prot., datë 22.02.2018, informon se: “Nga kontrolli në sistemin C@TS, rezulton se subjekti nuk ka detyrime tatimore të palikuiduara. Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore i ka deklaruar dhe paguar. Subjekti nuk ka pasqyra financiare të dorëzuara në sistemin C@TS, për arsye se është biznes i vogël, tatim i thjeshtuar mbi fitimin”.

Në analizë të përmbajtjes së kësaj shkrese, trupi gjykues vlerëson se Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër ka dhënë informacion vetëm për të dhënat e rezultuara nga sistemi elektronik dhe nuk është shprehur për mungesë të dhënash për subjektin, por për mungesë të pasqyrave financiare në sistemin elektronik. Sipas pikës 9 të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 32, datë 31.12.2013, “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”, i ndryshuar, të gjithë tatimpaguesit, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, duke filluar nga viti 2014, dorëzojnë “Deklaratën e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin” në rrugë elektronike. Shkresa nr. {***} prot., datë 07.07.2017, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër, në të dhënat e veta referon në pasqyrat financiare për vitet 2006-2013, të dhëna këto që përpunohen plotësisht me ato që përmbajnë pasqyrat financiare të dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit. Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se të dhënat e përcjella nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër me shkresën nr. {***} prot., datë 07.07.2017, janë të dhënat zyrtare të organit kompetent në fushën e tatimeve, për rrjedhojë është i drejtë vlerësimi i Komisionit, që ka konsideruar në analizën financiare për vitet 2005-2012 këto të dhëna, për fitimin e realizuar nga bashkëshortja e subjektit, nga aktiviteti si notere publike.

35. Subjekti pretendon se pasqyrat financiare të dorëzuara nga ai në ILDKPKI për vitet 2006 dhe 2007, kanë pasur parregullsi, të cilat janë sistemuar prej tij kur ka kaluar në kontroll të plotë në këtë organ në vitin 2009 dhe, në përfundim, ILDKPKI-ja ka vlerësuar sistemimin e bërë. Nga verifikimi i akteve të përcjella në Komision nga ILDKPKI-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 13.09.2018, trupi gjykues konstaton se më datë 10.04.2009, subjekti ka depozituar në ILDKPKI një deklaratë, në të cilën shpjegon se në deklaratat periodike të pasurisë në vitet 2006, 2007 dhe 2008 ai ka deklaruar gabim, pasi ka deklaruar qarkullimin vjetor dhe jo të ardhurën neto të bashkëshortes. Bashkëlidhur kësaj deklarate, subjekti ka paraqitur “Deklaratë e qarkullimit vjetor për vitin 2007”, Bashkia Peshkopi, deklaruese M.J., qarkullimi vjetor 3.000.000 lekë, fitimi vjetor 1.725.575 lekë. Në vitin 2014, ILDKPKI-ja ka kërkuar përsëri sqarime nga subjekti mbi të ardhurat nga veprimtaria e bashkëshortes për vitin 2007, duke qenë se subjekti ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme nga kontrolli i kryer për këtë vit.

36. Trupi gjykues konstaton se ILDKPKI-ja nuk rezulton që të ketë pranuar sistemimet e pretenduara nga subjekti, apo të ketë bërë ndonjë vlerësim mbi dokumentacionin e dorëzuar prej tij në vitin 2009 dhe në vitin 2014. Mbështetur edhe në konstatimin e bërë nga ILDKPKI-ja në raportin e kontrollit për deklaratën e pasurisë së rivlerësimit¹¹, se fitimi nga aktiviteti privat i noterisë së bashkëshortes në deklaratat e interesave private ndër vite në ILDKPKI, nuk përputhet me rezultatin financiar të konfirmuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit se ka bërë sisteme në ILDKPKI, në lidhje me fitimin nga aktiviteti i bashkëshortes, nuk është marrë në konsideratë as nga ILDKPKI në kontrollin e deklaratës së pasurisë së rivlerësimit. Trupi gjykues vlerëson gjithashtu se rezultoi e provuar që subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime kontradiktore gjatë procesit të rivlerësimit, në lidhje me fitimin e realizuar nga bashkëshortja e tij nga aktiviteti si notere publike. Në verifikim dhe analizë të këtyre deklarimeve kontradiktore, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti ka kryer veprime fiktive në vite, për të rritur të ardhurat nga fitimi i aktivitetit të bashkëshortes dhe, për rrjedhojë, edhe për deklarimet e likuiditeteve *cash* në deklaratat periodike të pasurisë dhe në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, për të justifikuar vlerat e tyre. Sa më sipër, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer veprime që cenojnë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, siç përcaktohet në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
37. Subjekti pretendon se Komisioni, në mënyrë të padrejtë, nuk ka konsideruar në analizën financiare për periudhën 2005-2012, pagat e bashkëshortes së tij si notere, duke u bazuar në një shkresë të ISSh-së, e cila nuk legjitimon institucionet e rivlerësimit për të thënë se në mungesë të të dhënave në sistem, nuk ka pasur pagë të bashkëshortes për vitet para vitit 2012. Nga verifikimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues konstaton se ISSh-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 10.07.2017, informon ILDKPKI-në në lidhje me të ardhurat financiare bruto dhe neto të ndara sipas viteve të punës, të deklaruara nga punëdhënësit joshitetërorë, për znj. M.J. ISSh-ja informon gjithashtu, se *të dhënat janë nxjerrë nga sistemi informatik i ISSh-së, i cili disponon të dhëna për kontributet të cilat mbledhen dhe dërgohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet webservice, të dhëna të cilat i disponojmë nga viti 2012 e në vazhdim.* Nga përmbajtja e shkresës si më sipërcituar, trupi gjykues konstaton se ISSh-ja ka përcjellë vetëm ato të dhëna që disponon nga sistemi informatik, nga viti 2012 e në vazhdim, duke u shprehur për të dhënat në përgjithësi, jo vetëm për të dhënat e znj. M.J. në veçanti. Për këtë arsye, trupi gjykues e vlerëson të drejtë pretendimin e subjektit se përmbajtja e shkresës nr. {***} prot., datë 10.07.2017, e ISSh-së, nuk provon që znj. J. nuk ka paguar sigurimet shoqërore dhe shëndetësore si e vetëpunësuar para vitit 2012. Subjekti pretendon gjithashtu, se Komisioni duhej të mbështetej në të dhënat e dërguara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër, me shkresën nr. {***} prot., datë 22.02.2018, sipas së cilës bashkëshortja e tij nuk ka detyrime tatimore të palikuiduara. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, trupi gjykues i referohet edhe shkresës me nr. {***} prot., datë 07.07.2017, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër, sipas së cilës të dhënat e fitimit për personin fizik M.J. bazohen në pasqyrat financiare të viteve përkatëse. Në pasqyrat financiare të dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, të cilave trupi gjykues, më sipër në këtë arsyetim, u dha vlerën e provës¹², personi fizik M.J. ka parashikuar zërin paga dhe zërin pagesa për sigurime shoqërore me një vlerë konkrete, të cilat përlllogariten si shpenzime, me qëllim llogaritjen e fitimit. Duke i parë këto të dhëna në harmoni me të dhënat e shkresës tjetër nr. {***} prot., datë 22.02.2018, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër, trupi gjykues arrin në përfundimin se është i drejtë pretendimi i subjektit se Komisioni, në analizën financiare për vitet 2005-2012, duhet të kishte

¹¹ Raporti i ILDKPKI-së për kontrollin e deklaratës së pasurisë së rivlerësimit është përcjellë në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 12.1.2018.

¹² Shih paragrafin 34 të këtij vendimi.

përlllogaritur edhe të ardhurat nga paga si notere e bashkëshortes së subjektit, sipas të dhënave të pasqyrave financiare të dorëzuara nga vetë ai në ILDKPKI, bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit.

38. Subjekti, në ankim, pretendon se Komisioni në analizën financiare për periudhën 2005-2012 nuk i ka përlllogaritur drejt shpenzimet e jetesës për familjen e tij. Trupi gjykues vëren se subjekti, në ankim, por edhe në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ në Komision, ka pretenduar për vitet 2005, 2006 dhe 2007 shpenzime jetese në vlera më të vogla sesa ato të konsideruara nga Komisioni, ndërsa për vitet 2008-2012, vlera më të larta. Komisioni, në vendim, shpenzimet e jetesës për familjen e subjektit të përbërë nga pesë persona, nuk i ka përlllogaritur sipas standardit të ILDKPKI-së, bazuar në INSTAT. Vlerat e shpenzimeve të jetesës të deklaruara nga subjekti në ankim, por edhe gjatë hetimit në Komision, për vitet 2005-2012 janë më të larta sesa vlerat sipas standardit të ILDKPKI-së, bazuar në INSTAT.

Në shqyrtim të pretendimit të subjektit, trupi gjykues vlerëson se vlerat e shpenzimeve të jetesës sipas standardit të ILDKPKI-së, bazuar në INSTAT, përcaktojnë një nivel mesatar shpenzimesh jetese për familjet sipas numrit të personave në përbërje të tyre dhe, për këtë arsye, Komisioni në analizën financiare për vitet 2005-2012 duhet të kishte konsideruar si vlera për shpenzimet e jetesës së familjes së subjektit, ato të deklaruara prej tij.

39. Në mbështetje të arsyetimit si më sipër për këtë shkak ankimi, trupi gjykues kreu analizën financiare për periudhën 2005-2012, për të vlerësuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të krijuar kursime *cash* gjatë kësaj periudhe. Në këtë analizë u konsideruan shpenzimet e jetesës sipas vlerave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në ankim, si dhe në të ardhurat e familjes u përfshinë edhe pagat e bashkëshortes së subjektit si notere publike, sipas vlerave të dhëna në pasqyrat financiare të dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit¹³.

Rezultati i analizës financiare për periudhën 2005-2012, megjithëse në vlerë më të vogël sesa ajo e rezultuar nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, përsëri është në vlerë negative, në total në vlerën 6.057.961 lekë.

Në përfundim, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti ka mungesë burimesh për të justifikuar kursimet *cash* të deklaruara si të dhëna hua te personat e tretë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, të krijuara në periudhën 2005-2012, siç përcaktohet në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime kontradiktore gjatë procesit të rivlerësimit dhe veprime fiktive në vite për të ardhurat nga fitimi i aktivitetit të bashkëshortes dhe, për rrjedhojë, dhe për deklaratimet e likuiditeteve *cash* në deklaratat periodike të pasurisë dhe në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit.

Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se pretendimi i subjektit është i pabazuar.

40. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se arsyetimi i Komisionit për huadhënien e parave nga ai te persona të tretë, është alogjik dhe abuziv, pasi faktet që trajtohen nuk bazohen në deklaratat përkatëse dhe në shpjegimet e subjektit të cituara edhe në vendim, të cilat qartësisht pasqyrojnë se gjendjen në lekë të dhënë hua, subjekti nuk e ka pasur të shpërndarë në vitin 2014, por ndër vite, duke pasur atë gjendje deri në fund të vitit 2016.

Trupi gjykues i Kolegjit, në lidhje me këtë pretendim, konstaton se në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar: “Gjendje *cash* në vlerën 1.296.645 lekë; Në huadhënie - përdorim personave të tjerë të lidhur në vlerën 12.000.000 lekë”.

¹³ Vlerat e pagave të bashkëshortes të dhëna në pasqyrat financiare të dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, janë: në vitin 2005 – 267.760 lekë; në vitin 2006 – 217.350 lekë; në vitin 2007 – 164.880 lekë; në vitin 2008 – 196.000 lekë; në vitin 2009 – 188.280 lekë; në vitin 2010 – 197.640 lekë; në vitin 2011 – 204.000 lekë; dhe në vitin 2012- 139.999 lekë.

Në të njëjtin deklaram, subjekti ka detajuar:

“8.000.000 lekë, të ardhura të krijuara ndër vite, ia kam dhënë në përdorim ndër vite, pa interes, z. E.T., sipas vërtetim-nënshkrimit nr. {***} rep., datë 25.01.2017;

2.000.000 lekë, të ardhura të krijuara ndër vite, ia kam dhënë në përdorim ndër vite, pa interes, z. A.R., sipas deklaratës nr. {***} rep., datë 24.01.2017;

2.000.000 lekë, të ardhura të krijuara ndër vite, ia kam dhënë në përdorim ndër vite, pa interes z. A.T., sipas deklaratës nr. {***} rep., datë 26.01.2017”.

Bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit, subjekti ka paraqitur deklaratat e shtetasve, të cilëve u ka dhënë hua shumat e pretenduara.

Sipas vërtetim-nënshkrimit nr. {***} rep., datë 25.01.2017, z. E.T. ka deklaruar se: “Ndër vite kam pasur në përdorim para në *cash* të shokut tim Ahmet Jangulli, të cilat i kam marrë pa kontratë të nënshkruar dhe pa interes. I kam marrë kur më janë dashur dhe i kam kthyer kur kam mbaruar punë. Konkretisht, një gjendje të tillë të lekëve e kam marrë, me sa më kujtohet, që nga viti 2014 deri nga fundi i vitit 2016. Aktualisht kam një gjendje *cash* të shokut tim Ahmet Jangulli, në shumën 8.000.000 lekë dhe akoma deri më sot nuk ia kam kthyer”.

Sipas deklaratës nr. {***} rep., datë 24.01.2017, z. A.R. ka deklaruar se: “Ndër vite kam pasur në përdorim para në *cash* të shokut tim Ahmet Jangulli, të cilat i kam marrë pa kontratë të nënshkruar dhe pa interes. I kam marrë kur më janë dashur dhe i kam kthyer kur kam mbaruar punë. Konkretisht një gjendje të tillë të lekëve e kam marrë, me sa më kujtohet, që nga viti 2014. Aktualisht kam një gjendje *cash* të shokut tim Ahmet Jangulli, në shumën 2.000.000 lekë dhe akoma deri më sot nuk ia kam kthyer”.

Sipas deklaratës nr. {***} rep., datë 26.01.2017, z. A.T. ka deklaruar se: “[...] deklaroj se për nevojat e mia familjare, i kam marrë hua para disa vitesh, burrit të motrës sime, z. Ahmet Jangulli, një shumë prej 2.000.000 lekësh. Deklaroj se kjo shumë më është dhënë hua pa interesa dhe kthimi më është lënë pa afat. Deklaroj se këtë shumë unë nuk ia kam kthyer dhëndrit tim Ahmet Jangulli”.

Bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit, subjekti ka paraqitur edhe një deklaratë të vetën, datë 27.01.2017¹⁴, në të cilën shpjegon se gjendjen në lekë nuk e ka në bankë, por i ka të shpërndara ndër vite, te miqtë e tij, pa kontrata të shkruara apo interesa për huat e dhëna. Huaja e dhënë është në shumën 12.000.000 lekë.

Komisioni, në vendim¹⁵, duke qëndruar në të njëjtat konstatime si në rezultatet e hetimit administrativ, ka konstatuar se sipas deklaratave noteriale të shtetasve E.T., A.R. dhe A.T., *huat në shumat 8.000.000 lekë dhe 2.000.000 lekë janë marrë në vitin 2014, ndërsa shuma 2.000.000 lekë para disa vitesh.*

41. Në ankim, subjekti kundërshton këtë konstatim të Komisionit, duke argumentuar se gjendjen në lekë *cash* të dhënë hua nuk e ka pasur të shpërndarë në vitin 2014, por ndër vite, duke pasur atë gjendje deri në fundvitin 2016. Në lidhje me këtë pretendim të subjektit, mbështetur në rrethanat faktike të analizuara si më sipër, trupi gjykues vlerëson se konstatimi i Komisionit, i bazuar në deklaratimet e shtetasve E.T., A.R. dhe A.T. është konstatim i drejtë. Komisioni, për të vlerësuar mundësinë e subjektit për të krijuar me burime të ligjshme shumat e dhëna hua te miqtë e të afërmit e tij, analizën financiare e ka shtrirë në periudhën 2005-2012, në kundërshtim me sa pretendon subjekti, se Komisioni, në analizën financiare nuk i ka shpërndarë shumat e dhëna hua prej tij, në vitin 2014. Trupi gjykues vlerëson se konstatimi i Komisionit, në lidhje me periudhën e huadhënies, megjithëse i saktë, nuk ka dhënë asnjë rezultat në analizën financiare.

Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se pretendimi i subjektit është i pabazuar.

¹⁴ Data e dorëzimit të deklaratës së pasurisë së rivlerësimit në ILDKPKI.

¹⁵ Shih faqen 7 të vendimit nr. 67, datë 05.10.2018, të Komisionit.

42. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se konkluzioni i Komisionit për gjendjen e likuiditeteve cash në vitet 2006, 2007 dhe 2008 është alogjik dhe abuziv, pasi faktet që trajtohen nuk bazohen në aktet përkatëse, të cilat qartësisht pasqyrojnë se për këto vite, pasaktësitë janë sistemuar nga subjekti në deklaratimet e bëra pranë ILDKPKI-së në vitet 2009 dhe 2014. ILDKPKI-ja nuk i ka bërë pjesë të raportit të saj këto akte dhe as nuk ia ka vënë në dispozicion Komisionit. Konkluzioni i Komisionit është i paargumentuar për rillogaritjet e kryera në vendim mbi rezultatet e hetimit administrativ, lidhur me gjendjen e cash-it, sepse sipas rillogaritjeve diferenca e pajustificuar është në vlerë më të vogël, sesa ajo e nxjerrë në rezultatet e hetimit administrativ.*

Trupi gjykues i Kolegjit, nga verifikimi i deklaratës së pasurisë së rivlerësimit dhe deklaratave të pasurisë në vite të subjektit, konstaton se subjekti ka deklaruar likuiditetet *cash*, si më poshtë. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit ka deklaruar: “Gjendje *cash* në vlerën 1.296.645 lekë. Në huadhënie - përdorim personave të tjerë të lidhur në vlerën 12.000.000 lekë”.

Në vitin 2003 nuk ka deklaruar gjendje *cash*.

Në vitin 2004 ka deklaruar: “gjendje nga paga e tij dhe e bashkëshortes në vlerën 400.000 lekë”.

Në vitin 2005 nuk ka deklaruar gjendje *cash*.

Në vitin 2006 ka deklaruar: “gjendje *cash* shtesë 1.400.000 lekë”.

Në vitin 2007 ka deklaruar: “gjendje *cash* shtesë 3.500.000 lekë”.

Në vitin 2008 ka deklaruar: “gjendje *cash* shtesë 3.700.000 lekë”.

Në vitin 2009 ka deklaruar: “gjendje *cash* shtesë 1.556.688 lekë”.

Në vitin 2010 ka deklaruar: “gjendje *cash* shtesë 1.371.507 lekë”.

Në vitin 2011 ka deklaruar: “gjendje *cash* shtesë 526.033 lekë”.

Në vitin 2012 ka deklaruar: “gjendje *cash* 636.540 lekë”.

43. Nga verifikimi i akteve të hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues konstaton se në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni, në analizën financiare për periudhën 2005-2012, ka përlllogaritur si kursime të subjektit, për çdo vit, gjendjen e *cash*-it të deklaruar prej tij, duke i shtuar edhe shtesat e gjendjeve në llogaritë bankare. Me kërkesë të Komisionit, ILDKPKI-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 13.09.2018, ka përcjellë deklaratat e subjektit dhe procesverbalet e deklarimeve të tij, të mbajtura me rastin e kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit në vitet 2009 dhe 2014. Nga akti “Procesverbal mbi shpjegimet e subjektit të deklaratimit të pasurive”, mbajtur në ILDKPKI, më datë 13.10.2014, trupi gjykues konstaton se subjekti i është kërkuar të japë shpjegime për mungesë burimesh për të justifikuar kursimet e deklaruara *cash* dhe ai ka dhënë shpjegime mbi të njëjtat konstatime të ILDKPKI-së si në vitin 2009, në lidhje me gjendjen e *cash*-it, dhe ka përdorur të njëjtat argumente si në vitin 2009, në lidhje me këtë gjendje.

44. Në ankim, subjekti ka argumentuar se në deklaratat periodike të pasurisë në vitet 2006, 2007 dhe 2008, ai ka deklaruar si shtesë gjendjen totale të parave *cash* dhe jo shtesën vjetore përkatëse. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, bazuar edhe në situatën faktike të deklarimeve si më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti, nga viti 2006 e deri në vitin 2012, ka pasur të njëjtën qasje të qëndrueshme, në drejtim të deklaratimit të parave *cash* në banesë, duke deklaruar shtesat e tyre vit pas viti, në përputhje edhe me sa kërkon formulari i deklaratimit periodik. Për këtë arsye, trupi gjykues vlerëson se deklaratimet e subjektit në deklaratat periodike, në lidhje me gjendjen e parave *cash*, janë konsideruar me të drejtë nga Komisioni si deklaratimet e vërteta, të cilat mbështeten në prova. Në vitin 2009 dhe në vitin 2014, shpjegimet e dhëna nga subjekti në ILDKPKI, në përgjigje të pyetjeve që i janë drejtuar nga inspektori përkatës, janë një përpjekje për të justifikuar mungesën e burimeve për kursimet e vitit 2007, duke ndryshuar deklaratimet e tij periodike, megjithëse ato kanë qenë në përputhje me kërkesat ligjore. Deklarimi i gjendjes *cash* të subjektit lidhet ngushtësisht me shumat e dhëna hua prej tij te persona të tretë, miqtë e tij, pasi shumatorja e gjendjes *cash* shtesë të deklaruar nga

subjekti në vitet 2006-2011¹⁶ është sa vlera totale e huave të dhëna nga subjekti te miqtë e tij, të cilat, siç edhe ai vetë pranon, janë dhënë jashtë sistemit bankar dhe pa kontrata. Në këtë vlerësim, trupi gjykues mban në konsideratë dhe pretendimet e vetë subjektit e deklarimet e miqve të tij, se huat i ka dhënë në vite të ndryshme, të paktën dy prej tyre deri para vitit 2014, si dhe se shumati i janë marrë dhe kthyer sipas nevojave të tyre.

45. Subjekti ka pretenduar se gabimet në deklarimet në vite të gjendjes së parave *cash*, i ka korrigjuar në vitin 2009 dhe në vitin 2014, kur ka kaluar në kontroll të plotë në ILDKPKI, por ky institucion nuk i ka bërë pjesë të raportit këto akte dhe nuk i ka dërguar as në Komision. Lidhur me këto pretendime të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit, mbështetur edhe në situatën faktike si më sipër, vlerëson se ILDKPKI-ja, bazuar në nenet 31 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, kryen një kontroll të plotë të pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe në përfundim përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, të cilin ia përcjell Komisionit. Ky është një proces kontrolli i ri, i posaçëm dhe i pavarur, për efekt të rivlerësimit, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 84/2014. ILDKPKI-ja ka paraqitur pranë Komisionit deklaratat e pasurisë në vite të subjektit, në të cilat deklarohet gjendja e parave *cash*, ashtu siç është konstatuar nga Komisioni. Deklaratat e pasurisë në vite, bazuar në nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, shërbejnë si provë për Komisionin ose Kolegjin. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit se ka korrigjuar në ILDKPKI deklarimet e tij periodike në lidhje me gjendjen e *cash*-it, është i pabazuar në prova.

46. Subjekti, në ankim, pretendon se konkluzioni i Komisionit është i paargumentuar, për rillogaritjet e kryera në vendim mbi rezultatet e hetimit administrativ, lidhur me gjendjen e *cash*-it, sepse, sipas rillogaritjeve, diferenca e pajustificuar është në vlerë më të vogël sesa ajo e nxjerrë në rezultatet e hetimit administrativ.

Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues konstaton se në vendim¹⁷, Komisioni ka bërë një rillogaritje të kursimeve të subjektit, pas shpjegimeve të tij për rezultatet e hetimit administrativ se në deklarimet periodike, në gjendjen e *cash*-it ai ka përfshirë edhe gjendjen në banka. Trupi gjykues vlerëson se në kundërshtim me sa pretendon subjekti, Komisioni ka argumentuar se përse është zvogëluar vlera e pamjaftueshmërisë së burimeve financiare të tij¹⁸.

Por pavarësisht nga sa ka konkluduar Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit, nga verifikimi i deklaratave periodike të subjektit, konstaton se në deklarimet periodike të pasurisë në vitet e marra në analizë 2005-2012, ka deklaruar veçmas shtesat në likuiditete në llogaritë bankare, në fund të vitit dhe veçmas gjendjet shtesë të *cash*-it. Pra, subjekti i ka pasur të qarta kërkesat e formularit të deklarimit, duke deklaruar në mënyrë konsekuente, veçmas shtesat e tij në likuiditetet *cash* dhe ato në sistemin bankar. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit se ka deklaruar bashkë me *cash*-in edhe gjendjet në llogaritë bankare nuk është i bazuar në deklarimet e tij periodike, të cilat shërbejnë si provë në këtë proces. Për pasojë, konkluzioni i Komisionit për t'i zbritur gjendjet e likuiditeteve në llogaritë bankare nga kursimet, nuk është i drejtë. Nëse analiza financiare për periudhën 2005-2012 do të kryhej bazuar në këtë arsyetim, rezultati negativ do të ishte në vlerë më të lartë sesa ajo e rezultuar nga analiza financiare e kryer në paragrafin 39 të këtij vendimi.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit është i pabazuar.

¹⁶ Shih deklarimet e gjendjes *cash* shtesë të subjektit në deklaratat e pasurisë në vite, të pasqyruara në paragrafin 24 të këtij vendimi.

¹⁷ Shih faqen 11 të vendimit nr. 67, datë 05.10.2018, të Komisionit.

¹⁸ Komisioni, në vendimin nr. 67, datë 05.10.201, në faqen 11 është shprehur: “d) Në analizën financiare të kryer nga Komisioni, gjendja e bankave në fund të çdo viti i është shtuar gjendjes së likuiditeteve të deklaruara nga subjekti. Pas sqarimit të subjektit se gjendja në banka është e përfshirë në totalin e kursimeve, trupi gjykues e merr në konsideratë pretendimin e tij [...]. Me rillogaritjet, duke marrë në konsideratë pretendimet e subjektit të rivlerësimit, situata financiare pasqyron se subjekti i rivlerësimit vazhdon të ketë pamjaftueshmëri në vlerën 6672.993 lekë.”

47. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se bashkëshortja e tij është trajtuar gabim si bashkëkredimarrëse në një kredi të marrë në Bankën Societe Generale Albania, pasi ajo në fakt ka qenë dorëzanëse. Për pasojë, konkluzioni i Komisionit për deklarim të pamjaftueshëm për shkak të mosdeklarimit të kësaj kredie nga subjekti, është arbitrar, pasi ai nuk kishte çfarë të deklaronte, në kushtet kur nuk kishte dijeni për veprimin dhe kur nuk bëhej fjalë as për pasuri dhe as për detyrime të familjes së tij.*

Në lidhje me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues i Kolegjit, nga aktet e administruara nga Komisioni, konstaton situatën faktike si vijon.

Komisioni, në vendim¹⁹, ka arritur në konkluzionin se *subjekti duhet ta kishte deklaruar këtë kredi, sepse de jure personi i lidhur figuron debitore e Bankës Societe Generale Albania, për pasojë e çmon atë si deklarim të pamjaftueshëm në lidhje me këtë kredi.*

Sipas informacionit të përcjellë nga Banka Societe Generale Albania në Komision²⁰, bashkëshortja e subjektit, znj. M.J., ka kredi me këste standarde bashkëmërore me shtetasen M.V., në monedhën lekë, sipas kontratës së kredisë bankare ekspres, me ofertë afatmesme me nr. {***}, datë 28.10.2014, në shumën 700.000 lekë. Kjo kredi është me status të palikuiduar në datën 31.01.2017, pjesa e principalit të mbetur për t'u likuiduar ka qenë 436.750 lekë.

Pika 8 e kontratës së sipërcituar parashikon se kredimarrësi është në dijeni të faktit, kupton dhe pranon plotësisht se kjo kontratë kredie bankare përbën titull ekzekutiv, në bazë të nenit 510, shkronja "d" e Kodit të Procedurës Civile dhe është menjëherë e ekzekutueshme kundrejt tij, në rastet e zgjidhjes së kontratës së kredisë, në veçanti në rast mospërmbushjeje detyrimi të pagimit të principalit të kredisë dhe interesit përkatës. Kjo kontratë është nënshkruar në cilësinë e kredimarrësit nga znj. M.V. dhe znj. M.J.

Llogaria bankare në të cilën është disbursuar kredia në vlerën 700.000 lekë, është llogari rrjedhëse dyemërore: M.J. ose M.V. Nga verifikimi i lëvizjeve të kryera në këtë llogari, trupi gjykues konstaton se pagesat e kredisë janë derdhur në mënyrë të rregullt nga znj. M.V. Plani i amortizimit të kredisë është lëshuar në emër të të dy bashkëkredimarrëseve, por është nënshkruar vetëm nga znj. M.V.

48. Në analizë të pretendimit të subjektit në raport me situatën faktike si më sipër, trupi gjykues vlerëson se bazuar në nenin 1043 të Kodit Civil, në rastin kur llogaria likuiduese është në emër të disa personave, me të drejtën për të kryer veprime edhe në mënyrë individuale, këta persona quhen kreditorë ose debitorë solidarë të tepricave të llogarisë. Bazuar edhe në përcaktimet e kontratës së kredisë, detyrimi kundrejt pagesës së kësaj kredie bie në mënyrë të njëjtë mbi kredimarrësit, znj. V. dhe znj. J., pavarësisht se, siç pretendon subjekti i rivlerësimit, qëllimi i lidhjes së kësaj kontrate nga znj. J. mund të ketë qenë dorëzania. Në këtë kuptim, bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, trupi gjykues çmon se subjekti dhe bashkëshortja e tij kishin detyrimin për të deklaruar këtë kredi në deklaratën e pasurisë së vitit 2014 e në vazhdim, si dhe detyrimin për deklarimin e saj në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, bazuar në nenin 31, pika 1 dhe në shtojcën nr. 2 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në pikën 24 të udhëzimit të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016. Trupi gjykues e gjen të provuar faktin e pretenduar nga subjekti se pagesat e kredisë janë derdhur në llogarinë bashkëmërore nga znj. V. por çmon se subjekti i kishte të gjitha mundësitë të shpjegonte në deklaratën e rivlerësimit qëllimin e nënshkrimit të kësaj kredie nga bashkëshortja e tij dhe detyrimin real të paguar prej saj. Në përfundim, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, bazuar në nenin D, pikat 1 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe në kundërshtim me nenin 33, pika 5, shkronja "a" e ligjit nr. 84/2016, për shkak të mosdeklarimit

¹⁹ Shih faqen 11 të vendimit nr. 67, datë 05.10.2018 të Komisionit.

²⁰ Informacion i përcjellë nga Banka Societe Generale Albania në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 16.02.2018.

të detyrimit të personit të lidhur/bashkëshortes së tij për kredinë e marrë prej saj në Bankën Societe Generale Albania.

Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit është i pabazuar.

C. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për kontrollin e figurës dhe shkaqet e ankimit lidhur me të

49. *Subjekti ka pretenduar se është cenuar në të drejtat e tij në këtë proces, pasi trajtimi i kontrollit të figurës i bërë në vendim, mbi informacionin e përcjellë nga DSIK-ja, nuk gjen pasqyrim në rezultatet e hetimit administrativ dhe, për këtë arsye, ai nuk ka dhënë sqarime lidhur me këtë çështje në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ. Komisioni nuk i ka kaluar barrën e provës lidhur me këtë kriter, pasi tjetër gjë është barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime për të provuar të kundërtën dhe krejt tjetër gjë është për të dhënë argumentet në lidhje me konstatimet, në të cilat qartësisht pasqyrohet se nuk kërkohet asnjë lloj argumenti për to.*

Në lidhje me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues i Kolegjit, në verifikim të akteve të administruara nga Komisioni, konstaton se në rezultatet e hetimit administrativ, subjekti është vënë në dijeni për përmbajtjen e raportit të kontrollit të figurës të DSIK-së, me nr. {***} prot., datë 03.07.2018, të deklasifikuar pjesërisht, në të cilin është konstatuar papërshtatshmëria e tij për ushtrimin e detyrës. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti ka pranuar se është njoftuar për të dhënë argumente në lidhje me konstatimet e bëra nga Komisioni dhe ka paraqitur shpjegime në lidhje me çështjen gjyqësore nr. {***}, datë 12.07.2004, të shqyrtuar prej tij në cilësinë e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë.

Në seancën dëgjimore të datës 03.10.2018, relatorja e çështjes ka prezantuar përmbajtjen e dosjes së subjektit të rivlerësimit. Në këtë seancë, relatorja, përveç sa është shprehur në rezultatet e hetimit, ka shtuar se subjekti, në vendimin e dhënë në cilësinë e gjyqtarit të vetëm të çështjes nr. {***}, datë 12.07.2004, ka çmuar ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale për dy nga të pandehurit. Në vijim, relatorja ka referuar se Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, pasi dukej sikur ishin favorizuar shtetasit e akuzuar për këtë çështje.

Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit ka pranuar se është njohur me të gjitha materialet e dosjes së rivlerësimit dhe nuk është shprehur në lidhje me konstatimin për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, të paraqitur nga relatorja e çështjes, si dhe nuk ka ngritur asnjë pretendim në lidhje me mungesën e kalimit të barrës së provës. Këtë pretendim, subjekti e ngrë për herë të parë në ankim.

50. Në analizë të rrethanave të sipërcituara, trupi gjykues vlerëson se Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, për të gjitha çështjet që janë konstatuar gjatë hetimit administrativ dhe subjektit i është dhënë mundësia për të dhënë shpjegime me shkrim gjatë hetimit, si dhe në seancë dëgjimore. Perceptimi apo kuptimi i gabuar i subjektit, në lidhje me atë që parashikon Aneksi i Kushtetutës në nenet Ç dhe Dh për barrën e provës, nuk është përgjegjësi e Komisionit, për sa kohë në rezultatet e hetimit dhe në seancë dëgjimore, subjekti i është bërë e njohur qartësisht se Komisioni i ka kaluar barrën e provës, duke i bërë të ditur dhe bazën ligjore për këtë kalim.

Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

51. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se për llogari të kontrollit të figurës, është e dyta herë që i nënshtrohet kontrollit, së pari në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe së dyti për llogari të deklaratës së kontrollit të figurës dhe, në këto rrethana, i takon qartësisht e plotësisht që të jetë para “gjësë së gjykuar”.*

Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, nga verifikimi i dokumentacionit të përcjellë në Komision nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër me shkresën nr. {***} prot., datë 06.08.2018,

që i përket dosjes gjyqësore me nr. {***}, datë 12.07.2004, trupi gjykues konstaton se vendimi nr. {***}, datë 08.11.2004, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, me gjyqtar subjektin e rivlerësimit, është ankimuar nga prokurori i çështjes dhe nga i pandehuri K.A. Gjykata e Apelit Tiranë, pas shqyrtimit të çështjes, ka dhënë vendimin nr. {***}, datë 17.06.2005. Bazuar në këtë fakt, subjekti në ankim, pretendon se shqyrtimi i kësaj çështjeje për herë të dytë nga Komisioni, për llogari të kontrollit të figurës, e vendos atë në kushtet e “gjësë së gjykuar”.

52. Lidhur me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues arsyeton se Kodi i Procedurës Civile në nenin 451/a, paragrafi i dytë, parashikon se: “Vendimi që ka marrë formë të prerë, ka fuqi vetëm për çka është vendosur midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të gjykohet përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe”. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, rezulton se objekti i gjykimit në apel ka qenë shqyrtimi në shkallë të dytë i çështjes penale që i përkiste të pandehurve SH.L., M.S. dhe K.A., ndërsa Komisioni nuk ka shqyrtuar çështjen penale me qëllim për t’i dhënë zgjidhje asaj me pasoja konkrete për palët, por ka analizuar qëndrimin dhe sjelljen profesionale të subjektit të rivlerësimit, si gjyqtari që ka gjykuar këtë çështje në gjykimin në shkallë të parë. Trupi gjykues vlerëson se Komisioni ka vepruar në përputhje të plotë me kompetencën që i ka dhënë neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe neni 4 i ligjit nr. 84/2016, për kryerjen e procesit të rivlerësimit. Në kundërshtim me sa pretendon, procesi i rivlerësimit për subjektin nuk gjendet në kushtet e “gjësë së gjykuar”, pasi të njëjtat fakte mund t’u shërbejnë në mënyrë të pavarur procedimeve të ndryshme, të cilat ndjekin qëllime të ndryshme, sikurse rasti konkret.

Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

53. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se arsyetimi i bërë në vendimin e Komisionit është alogjik dhe abuziv, pasi faktet që trajtohen nuk bazohen në aktet përkatëse që citohen edhe në vetë vendimin e Komisionit, sepse, për sa i përket argumentit mbi të dhënat që kanë rezultuar nga procesverbalet e seancave gjyqësore, Komisioni ka pasqyruar më pak argument sesa në rezultatet e hetimit administrativ, ku është hequr pjesa që e ka mbajtur në këmbë hetimin.* Trupi gjykues, në shqyrtim të këtij shkakut ankimi të subjektit, nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni, konkretisht nga verifikimi i përmbajtjes së vendimit nr. 67, datë 05.10.2018²¹, në lidhje me arsyetimin për kriterin e kontrollit të figurës, si dhe rezultateve të hetimit administrativ, të cilat ia ka bërë të njohura subjektit me vendimin nr. 2, datë 13.09.2018, konstaton se Komisioni ka dhënë të njëjtin argument në rezultatet e hetimit dhe në vendim, në lidhje me atë që ka konstatuar nga përmbajtja e procesverbaleve gjyqësore të çështjes penale nr. {***}, datë 12.07.2004. Gjithashtu, në vendim, Komisioni ka shprehur edhe qëndrimin e subjektit në lidhje me procesverbalet dhe me aktet e paraqitura nga prokurori i çështjes.
54. Trupi gjykues vlerëson se arsyetimi i vendimit të Komisionit nuk është mbështetur në atë se çfarë u bë më tej me aktet e fashikullit gjyqësor, por mbi faktin e ndryshimit të cilësimit të veprës penale nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të çështjes. Në lidhje me këtë fakt, subjekti nuk ka dhënë shpjegime në ankim, por ka pretenduar se arsyetimi i Komisionit nuk qëndron, pasi nuk bazohet në aktet përkatëse, të cilat qartësisht pasqyrojnë se prokurori i çështjes nuk ka bërë dy kërkime para gjykatës, por vetëm një. Nga verifikimi i akteve të dosjes gjyqësore nr. {***}, datë 12.07.2004, trupi gjykues konstaton se sipas procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 08.11.2004, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë, në diskutimin përfundimtar për procedimin penal nr. {***} të vitit 2004, i dorëzuar me shkrim, prokurori i çështjes ka kërkuar përfundimisht: “Deklarimin fajtor të të pandehurit Sh.L. për veprën penale të falsifikimit të letërnjoftimeve apo vizave nëpërmjet

²¹ Shih faqen 13 të vendimit nr. 67, datë 05.10.2018, të Komisionit.

përdorimit të tyre, vepër kjo e parashikuar nga neni 189/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me dy vjet burgim; Deklarimin fajtor të të pandehurit M.S. për veprën penale të falsifikimit të letërnjoftimeve apo vizave nëpërmjet përdorimit të tyre, vepër kjo e parashikuar nga neni 189/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me dy vjet burgim; Deklarimin fajtor të të pandehurit K.A. për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, vepër kjo e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me një vit burgim”. Nga sa cituar më sipër, trupi gjykues vlerëson se prokurori i çështjes ka bërë dy kërtime para gjykatës, në ndryshim nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit.

Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

55. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se arsyetimi i Komisionit nuk është ligjor, pasi vlerësimi për kontrollin e figurës nuk është brenda periudhës së vlerësimit, në zbatim të ligjit nr. 84/2016. Përfundimi i Komisionit se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e figurës nuk qëndron dhe është alogjik e abuziv, sepse lehtësisht konstatohet se arsyetimi i vendimit bazohet vetëm në raportin e DSIK-së, pa hartuar Komisioni një raport të vetin për këtë kriter. Në shqyrtim të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues i Kolegjit, referuar të dhënave të raportit të DSIK-së dhe informacionit të përcjellë nga KLD-ja, konstaton se veprimtaria korruptive e dyshuar e subjektit të rivlerësimit ka ndodhur në vitin 2004, kur subjekti ka qenë në detyrën e gjyqtarit dhe kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë²².*

Në lidhje me pretendimin e subjektit se vlerësimi i kontrollit të figurës nuk është brenda periudhës së vlerësimit, në kundërshtim me ligjin nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se neni Dh i Aneksit të Kushtetutës, në pikën 2 përcakton se *subjektet e rivlerësimit plotësojnë dhe i dorëzojnë Komisionit një deklaratë të detajuar për figurën e tyre që mbulon periudhën nga data 1 janar 2012 deri në ditën e deklaramit, sipas ligjit. Deklarata mund të përdoret si provë vetëm në këtë proces dhe në asnjë rast gjatë një procesi penal.* Ndërsa ligji nr. 84/2016, në nenin 34 të tij parashikon se kontrolli i figurës bëhet sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës. Neni Dh i Aneksit të Kushtetutës i sipërcituar, periudhën “nga data 1 janar 2012 e deri në ditën e deklaramit” e lidh vetëm me plotësimin e deklaramit të figurës prej subjektit të rivlerësimit. Ligji nr. 84/2016, i cili detajon procedurën e kontrollit të figurës, të kryer nga DSIK-ja dhe Komisioni, në asnjë rast nuk e kufizon kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit vetëm për periudhën nga 1 janari 2012 e deri në ditën e deklaramit të subjektit. Bazuar në nenin 38, pikat 4 dhe 6 të ligjit nr. 84/2016, kontrolli për figurën bazohet në dy komponentë komplementarë të njëri-tjetrit, në elementin përmbajtësor të këtij kontrolli, i cili është konstatimi i ekzistencës së kontaktit të papërshtatshëm, si dhe në elementin formal që është konstatimi i plotësisë dhe besueshmërisë së deklaramit. Mjaftueshmëria dhe vërtetësia e deklaramit kontrollohen për periudhën e deklaramit në Kushtetutë, ndërsa për sa i përket aspektit përmbajtësor të kontrollit të figurës, afati i tij mund të shtrihet edhe përpara datës 1 janar 2012.

56. Ligji nr. 84/2016 në nenin 38, pika 5, shkronja “d” përcakton si rrethanë lehtësuese që merret parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, kur *kontaktet e subjektit të rivlerësimit kanë qenë pesë vjet më parë dhe nuk ka ndonjë tregues që ato vazhdojnë ende. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me shkallën e seriozitetit të kontakteve dhe/ose me rrethanat e parashikuara në pikën 4 të këtij neni.* Ky përcaktim e shtrin kontrollin përmbajtësor të figurës në verifikimin e kontakteve të papërshtatshme edhe para datës 1 janar 2012, por kjo do të duhet të konsiderohet si rrethanë lehtësuese, e cila do të vlerësohet më pas, sipas kushteve të përcaktuara më tej në këtë dispozitë. DSIK-ja, në përputhje me nenin 38, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në raportin për subjektin, e ka cilësuar distancën kohore si një rrethanë lehtësuese, por duke vlerësuar rëndësinë e veprimit

²² Vërtetuar kjo edhe nga formulari i vetëvlerësimit profesional.

dhe cenimin e pastërtisë së figurës së subjektit të rivlerësimit e ka vlerësuar atë si një veprimtari të paligjshme, duke konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës. Sa më sipër, Komisioni, me të drejtë ka vlerësuar të mos e marrë në konsideratë rrethanën lehtësuese, në vlerësimin e kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se vlerësimi për kontrollin e figurës nuk është brenda periudhës së vlerësimit, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, është i pabazuar.

57. Në lidhje me pretendimin e subjektit se përfundimi i Komisionit për deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e figurës nuk qëndron, sepse lehtësisht konstatohet se arsyetimi i vendimit bazohet vetëm në raportin e DSIK-së, pa hartuar Komisioni një raport të vetin për këtë kriter, trupi gjykues vlerëson se ligji nr. 84/2016 në kreun V, “Kontrolli i figurës”, nuk parashikon detyrim për Komisionin për të hartuar një raport të posaçëm në lidhje me këtë kriter, por këtë kompetencë ia ka dhënë në nenin 39, pika 2, grupit të punës të DSIK-së, si organ ndihmës në këtë proces. Komisioni ka hetuar në lidhje me të dhënat e paraqitura nga raporti i DSIK-së dhe rezultatet e hetimit i ka paraqitur në rezultatet e hetimit administrativ, të cilat janë përmbledhje e gjetjeve të Komisionit për të tria kriteret e vlerësimit, përfshirë edhe kontrollin e figurës. Rezultatet e hetimit i janë bërë të njohura subjektit, bazuar në nenin Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, duke i kaluar barrën e provës për të kundërtën e asaj që ka rezultuar nga hetimi paraprak.

Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

58. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se konkluzioni i Komisionit se informacioni i dhënë nga DSIK-ja për veprime korruptive në bashkëpunim me një prokuror, gjen mbështetje edhe nga hetimi administrativ mbi dosjen, është alogjik dhe abuziv, pasi nuk arsyetohet për asgjë se çfarë ka vërejtur trupi gjykues për veprimet korruptive, nuk jep asnjë indicie, provë, ose gjetje që lidhin veprimet korruptive me rrethanat e ndryshimit të kualifikimit të veprës penale, duke e vendosur subjektin në kushtet që nuk mund të japë asnjë argument për to. Arsyetimi i Komisionit nuk qëndron, pasi subjekti nuk ka lënë asgjë pa deklaruar për llogari të kontrollit të figurës, sipas formularit përkatës të deklaramit.*

Në analizë të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues i Kolegjit, nga aktet e administruara gjatë hetimit në Komision, konstaton situatën faktike si më poshtë.

DSIK-ja ka dërguar në Komision raportin nr. {***} prot., datë 31.07.2018, mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, të deklasifikuar pjesërisht²³, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. DSIK-ja informon se nga institucionet verifikuese raportohet se për subjektin e rivlerësimit disponohen të dhëna në kohështrirje para dhe gjatë periudhës së rivlerësimit, ku ngrihen dyshime për përfshirje në veprimtari korruptive në disa procese gjyqësore. Informacionet që disponohen në ngarkim të subjektit të rivlerësimit për veprimtari korruptive, evidentojnë rrethanat e konstatimit të faktit se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me person/persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimit të pikës 6 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, në formën e takimit të qëllimshëm, në papajtueshmëri të plotë me ushtrimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit. Bazuar në sa më sipër, grupi i punës i DSIK-së ka konfirmuar konstatimin për papërshtatshmërinë për ushtrimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

59. Pas hetimit dhe verifikimit, Komisionit i rezultoi se çështja e vetme e gjykuar prej subjektit të rivlerësimit në periudhën e referuar, i përket dosjes gjyqësore me nr. {***}, datë 12.07.2004, ndaj shtetasve Sh.L., M.S. e K.A., akuzuar përkatësisht dy të parët për veprën penale “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, e parashikuar nga nenet 189/1 dhe

²³ Sipas kërkesës së Komisionit me nr. {***} prot., datë 27.07.2018, drejtuar DSIK-së për rishikimin e raportit për pastërtinë e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke përfshirë informacionet nga organet ligjzbatuese, si dhe deklasifikimin e tij.

25 të Kodit Penal dhe i treti për veprën penale “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Në përgjigje të hetimit të kryer nga Komisioni, Inspektorati i KLD-së me shkresën nr. {***} prot., datë 07.08.2018, ka përcjellë raportin për çështjen gjyqësore nr. {***}, datë 12.07.2004, për subjektin e rivlerësimit, në të cilin pasqyron analizën e saj nga pikëpamja profesionale, duke konstatuar problematika si në vijim.

a) Gjyqtari ka shtyrë seancën e tretë gjyqësore, duke i kërkuar Dhomës së Avokatisë Dibër caktimin e avokatit pa përcaktuar emrin dhe mbiemrin e mbrojtësit, ndonëse sipas nenit 49 të Kodit të Procedurës Penale, caktimi i mbrojtësit i përket gjykatës, bazuar në listat e avokatëve të referuara nga Dhoma e Avokatisë.

b) Në seancën e katërt gjyqësore, kur nuk është paraqitur asnjë avokat nga Dhoma e Avokatisë, e cila nuk dokumentohet të ketë pasur njoftim për një kërkesë të tillë, gjyqtari ka lejuar heqjen dorë të mbrojtësit D. M. nga mbrojtja e të pandehurit SH.L., me masën “arrest me burg” dhe ka pranuar kërkesën e këtij mbrojtësi, që të caktohej ai si mbrojtës për të pandehurin M.S. në mungesë dhe për të cilin gjyqtari ka dhënë vendim pafajësie në fund të gjykimit. Ky veprim është në shkelje të neneve 49 dhe 54 të Kodit të Procedurës Penale. Gjyqtari nuk ka reaguar në kohën e duhur për kërkesat procedurale të palëve, pasi ka shtyrë seancën për t’u prononcuar në lidhje me kërkesat e të pandehurit dhe avokatit për gjykim të shkurtuar, në mënyrë të panevojshme, duke mos pasur parasysh kriteret e nenit 403 të Kodit të Procedurës Penale, sepse i pandehuri ka qenë në mungesë dhe mbrojtësi ka qenë i caktuar kryesisht, i papajisur me prokurë të posaçme nga i pandehuri, pra, pa pasur tagrin për të kërkuar gjykim të shkurtuar. Pavarësisht këtij shkak që haptazi pengonte zhvillimin e gjykimit të shkurtuar, gjyqtari i ka kërkuar prokurorit akte të hetimit paraprak dhe ky i fundit ka konfirmuar se kishte akte të tilla, që i ka dhënë shkak urdhrin të gjyqtarit për paraqitjen e këtyre akteve nga prokurori para seancës së radhës. Në të kundërt të këtij urdhri, në seancën e radhës, prokurori ka deklaruar se nuk ka akte të tilla dhe ky deklarim është pranuar nga gjyqtari, i cili ka refuzuar kërkesën për gjykim të shkurtuar për shkak të mungesave procedurale dhe jo për shkak të përmbajtjes së akteve të hetimit paraprak.

c) Në seancën e gjashtë, të pandehurit kanë bërë deklaramë para gjykatës, të cilat janë konvertuar në pyetje përgjigje, pa u ndjekur procedura e pyetjes së të pandehurit sipas nenit 358 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo procedurë është emërtuar në procesverbal “dëshmi e të pandehurit”, që tregon paqartësinë e gjyqtarit për mjetet e kërkimit të provave dhe për garancitë procedurale të të pandehurve në gjykim.

60. Nga përmbajtja e konkluzioneve të nxjerra nga raporti i KLD-së, rezultateve të hetimit administrativ dhe procesverbalit të seancës dëgjimore në Komision, trupi gjykues konstaton se Komisioni ia ka vënë në dispozicion subjektit të gjitha aktet e hetimit administrativ dhe subjekti është njohur me to. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ dhe në seancë dëgjimore, subjekti ka kundërshtuar vetëm shkeljet procedurale të cituara nga Komisioni në rezultatet e hetimit.
61. Në ankim, subjekti pretendon se nuk ka paraqitur shpjegime për raportin e DSIK-së, pasi në vendimin e Komisionit nuk arsyetohet për asgjë se çfarë ka vërejtur trupi gjykues për veprimet korruptive, nuk jep asnjë indicie, provë ose gjetje që lidhin veprimet korruptive me rrethanat e ndryshimit të kualifikimit të veprës penale, duke e vendosur subjektin në kushtet që nuk mund të japë asnjë argument për to. Në lidhje me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues vlerëson se në raportin e përditësuar për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, grupi i punës i DSIK-së ka sqaruar rrethanat, për të cilat ka konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, të cilat datojnë në vitin 2004. Në vendim²⁴, Komisioni, në konkluzionin për kriterin e kontrollit të figurës dhe dhënien e masës disiplinore, i referohet pikës 1 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, i cili përcakton se kontrolli

²⁴ Shih faqen 14 të vendimit nr. 67, datë 05.10.2018 të Komisionit.

i figurës zhvillohet bazuar në prova të sakta, në informacione konfidenciale, si dhe informacione të tjera të disponueshme. Por rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, përcaktohen në pikën 4 të nenit 38²⁵. Përkufizimi se cili do të konsiderohet person “i përfshirë në krimin e organizuar” jepet në pikën 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës “person i përfshirë në krimin e organizuar” është personi i dënuar ose i proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar (në vijim ligji nr. 10192/2009, i ndryshuar).

62. Raporti i grupit të punës së DSIK-së, megjithëse ka konstatuar se janë evidentuar rrethanat e konstatimit të faktit se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimit të pikës 6 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, në formën e takimit të qëllimshëm në papajtueshmëri të plotë me ushtrimin e detyrës, nuk identifikon se cilët janë personat e përfshirë në krimin e organizuar. Edhe nga përmbajtja e rezultateve të hetimit administrativ dhe e vendimit të Komisionit, rezulton se subjektit të rivlerësimit nuk i atribuohet ndonjë kontakt me person/persona konkretë nominalë të përfshirë në krimin e organizuar. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se në mungesë të identifikimit të personit konkret, në funksion të analizës, do të duhet të bëjë dy prezumime në lidhje me personin/personat e mundshëm me të cilët subjekti ka pasur kontakt të papërshtatshëm.
63. Në prezumimin e parë, personat e kontaktit të papërshtatshëm janë ata në cilësinë e të pandehurit në çështjen nr. {***}, datë 12.07.2004. Këta persona të padënuar më parë, janë proceduar penalisht për veprat penale të parashikuara nga nenet 189/2, 25 dhe 245 të Kodit Penal, vepra të cilat nuk përfshihen në ato të parashikuara nga pika 1 e nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, i ndryshuar, sipas përcaktimit të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë kuptim, trupi gjykues vlerëson se këta persona nuk plotësojnë kushtin ligjor për t'u kategorizuar në rrethin e personave të përfshirë në krimin e organizuar. Në prezumimin e dytë, personi me të cilin subjekti ka pasur kontakt të papërshtatshëm është prokurori i çështjes. Në analizë të këtij prezumimi, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka thelluar hetimin administrativ, duke i kërkuar Prokurorisë së Përgjithshme informacion²⁶ mbi ecurinë e procedimit penal nr. {***}, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër për të pandehurit Sh.L., M.S. e K.A., si dhe mbi veprimet e prokurorit në këtë procedim. Në opinionin e dërguar me shkresën nr. {***} prot., datë 20.09.2018, Prokuroria e Përgjithshme ka evidentuar se nga tërësia e të gjitha veprimeve hetimore të kryera në procedimin penal nr. {***}, rezulton se nga ana e prokurorit tregohet vëmendje në kryerjen e veprimeve hetimore në dinamikë dhe respektim të afateve ligjore të kërkuara nga neni 323/1 i Kodit të Procedurës Penale, duke i dhënë një zgjidhje të drejtë çështjes. Në shprehjen e qëndrimit të tij në zgjidhjen e çështjes, prokurori përpiqet të argumentojë duke ndërthurur faktet e rezultuara nga hetimi dhe ekzistencën e elementeve të veprës penale. Aktet procedurale janë administruar në mënyrë të rregullt prej tij, çka synon paraqitjen korrekte dhe të plotë të veprimtarisë së tij si prokuror.

²⁵ Neni 38, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 përcakton:

a) subjekti i rivlerësimit është fotografuar, ose kur një dëshmitar përshkruan një takim me një person të përfshirë në krimin e organizuar;
b) subjekti i rivlerësimit ose personi i lidhur me të ka pasur një komunikim jorastësor me një person të përfshirë në krimin e organizuar;
c) subjekti i rivlerësimit ose një person i lidhur me të ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar;
ç) subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar;
d) subjekti i rivlerësimit merr pjesë ose është i pranishëm në takime me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar. Anëtarësia e dyshuar e personit në krimin e organizuar duhet të jetë e njohur, e publikuar, ose të jetë një çështje e dokumentuar në regjistrat përkatës.”

²⁶ Me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 01.08.2018.

Trupi gjykues konstaton se për prokurorin e çështjes, gjatë hetimit të Komisionit nuk kanë rezultuar të dhëna që të jetë dënuar ose proceduar penalisht, sipas përcaktimeve të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, apo për ndonjë veprë penale të parashikuar nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, sipas përcaktimeve të nenit 3, pika 8 e ligjit nr. 84/2016.

Trupi gjykues vlerëson se prokurori i çështjes nuk plotëson kushtin ligjor për t'u kategorizuar në rrethin e personave të përfshirë në krimin e organizuar.

64. Bazuar në analizën e prezumimeve si më sipër, trupi gjykues vlerëson se nuk provohet fakti që subjekti i rivlerësimit të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parashikimeve të nenit 3, pikat 6, 8 dhe 15 të ligjit nr. 84/2016. Formulari i deklarimit për kontrollin e figurës, bazuar në nenin Dh, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, plotësohet nga subjekti i rivlerësimit për periudhën nga data 1 janar 2012 deri në ditën e deklarimit. Sipas pikës 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, raporti i DSIK-së duhet të përcaktojë nëse subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi; nëse ka informacion në deklarimin e tij ose gjetkë që tregon se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, si dhe konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë e tij për vazhdimin ose jo të detyrës. Ngjarja për të cilën referon raporti i DSIK-së i deklasifikuar pjesërisht, ka ndodhur në vitin 2004 dhe grupi i punës nuk ka arsyetuar mbi plotësim jo të saktë dhe jo të plotë të deklaratës për kontrollin e figurës nga ana e subjektit. Standardet e kontrollit të figurës përcaktohen nga neni 38 i ligjit nr. 84/2016, ndërsa rrethanat që merren parasysh në konstatimin se formulari i deklarimit nuk është i plotë dhe i besueshëm, përcaktohen në pikën 6 të po këtij neni. Komisioni, në vendim, në analizën dhe arsyetimin mbi kriterin e kontrollit të figurës, nuk rendit asnjë nga rrethanat e mësipërme të nenit 38, pika 6, megjithëse ka arritur më pas në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Bazuar në faktin se rrethanat e konstatuara nga grupi i punës së DSIK-së dhe Komisioni i përkasin një periudhe tej afatit kushtetues, nga 1 janari 2012 e deri në ditën e deklarimit, si dhe bazuar në analizën e situatës faktike e ligjore si më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës, sipas parashikimeve të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, nuk është i bazuar në prova e në ligj dhe, për rrjedhojë, nuk është i drejtë.
65. Por, megjithëse e gjen të bazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ai nuk ka kryer deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës, trupi gjykues vlerëson se qëndrojnë problematikat e konstatuara nga KLD-ja²⁷ në shqyrtimin e dosjes gjyqësore nr. {***}, datë 12.07.2004, nga subjekti i rivlerësimit. Veprimet procedurale të subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm të çështjes, në shkelje të dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Penale, duket se kanë favorizuar të pandehurin M.S. në mungesë, për të cilin në përfundim të gjykimit, gjykata me vendimin nr. {***}, datë 08.11.2004, ka shpallur pafajësinë. Trupi gjykues çmon se kjo sjellje procedurale e subjektit cenon besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

Ç) Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për vlerësimin e aftësive profesionale dhe shkaqet e ankimit lidhur me të

66. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se për llogari të vlerësimit profesional, i është nënshtruar kontrollit katër herë, një herë para Inspektoratit të KLD-së me arkivimin e ankesës, një herë në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë me shfuqizimin e vendimit nr. {***}, datë*

²⁷ Shih paragrafin 59 të këtij vendimi.

03.03.2015, të KLD-së për masën disiplinore “Vërejtje me paralajmërim”, një herë para KLD-së me rrëzimin e kërkesës së ministrit të Drejtësisë për propozimin për masën disiplinore “Shkarkim nga detyra” dhe tani për llogari të formularit të vetëvlerësimit profesional. Në këto rrethana, i takon qartësisht e plotësisht që subjekti të jetë para “gjësë së gjykuar”.

Në lidhje me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues çmon se vlerësimi i aftësive profesionale për efekt të procesit të rivlerësimit, bazohet në përcaktimet e nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe në ato të ligjit nr. 84/2016. Subjekti, për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, plotëson formularin e vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 bashkëlidhur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, dhe e dërgon pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale. Bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i KLD-së rishikon dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi. Inspektorati i KLD-së, në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar. Ky raport i paraqitet Komisionit, ku relatori i çështjes përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale, mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe në akte të tjera ligjore. Procesi i rivlerësimit për kriterin e vlerësimit profesional autorizohet nga ligji i posaçëm nr. 84/2016, me qëllim dhe funksion të përcaktuar. Rivlerësimi për shkak të ligjit nr. 84/2016, aplikohet dhe kryhet vetëm një herë dhe vendimmarrja u përket organeve të rivlerësimit. Vlerësimi profesional i subjekteve të rivlerësimit, bazuar në nenin 41, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 kryhet për tri vitet e fundit të ushtrimit të detyrës nga hyrja në fuqi e këtij ligji, periudhë për të cilën KLD-ja, si organi kompetent për vlerësimin profesional të gjyqtarëve për këtë kohë, nuk kishte kryer asnjë procedurë dhe raport vlerësimi për gjyqtarët në detyrë. Rastet e cituara nga subjekti në shkaku e ankimit lidhen me ankesa të depozituara për të në KLD, të cilat janë përcjellë nga ky institucion në Komision, bazuar në nenin 41, pika 1 dhe nenin 44, paragrafi i parë i ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, procesi i rivlerësimit për këtë kriter, për subjektin e rivlerësimit, nuk gjendet në kushtet e zbatimit të parimit të “gjësë së gjykuar”.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit është i pabazuar.

67. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se rivlerësimi profesional i Komisionit është kryer mbi qëndrimin e subjektit, ndërkohë që bazuar në legjislacionin përkatës kërkohet e kundërta, duhet qëndrimi i subjektit ndaj vlerësimit profesional të institucioneve të rivlerësimit. Me arsyetimin në vendim nuk mund të konsiderohet procesi i rivlerësimit për llogari të kontrollit të aftësive profesionale në përfundim të një hetimi administrativ, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Arsyetimi i vendimit të Komisionit është abuziv dhe alogjik, pasi nuk bazohet në relacionin e rivlerësimit sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, i cili nuk është përgatitur si i tillë, nga relatorja e çështjes.*

Lidhur me këtë shkak ankimi të subjektit, trupi gjykues i Kolegjit, nga verifikimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, konstaton se Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ i ka bërë të njohur subjektin edhe përmbajtjen e raportit të vlerësimit profesional, të përgatitur nga KLD-ja. Komisioni e ka njoftuar subjektin për kalimin e barrës së provës, për të dhënë shpjegime në bazë të ligjit nr. 96/2016, për sa rezulton nga raporti i KLD-së. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti ka dhënë sqarime të hollësishme në lidhje me gjetjet e këtij raporti, për secilin nga elementet përbërëse të tij dhe për secilin nga kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas ligjit nr. 96/2016.

Në seancën dëgjimore të datës 03.10.2018, relatorja e çështjes në shpjegim të përmbajtjes së dosjes së rivlerësimit, ka shpjeguar se në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioni është bazuar në raportin për analizimin e aftësive profesionale të kryer nga KLD-ja, në kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016 dhe në

denoncimet e publikut. Më tej, në këtë seancë dëgjimore subjekti ka dhënë shpjegimet e tij përfundimtare në lidhje me këtë kriter.

68. Trupi gjykues vlerëson se ligji nr. 84/2016, në asnjë rast nuk parashikon mundësinë e dhënies së konkluzioneve nga Komisioni, para dhënies së vendimit përfundimtar. Është vendimi përfundimtar akti procedural kryesor i të gjithë procesit të rivlerësimit dhe, për këtë arsye, ai shpallet në përfundim të seancës dëgjimore. Ai përmbledh dhe finalizon përfundimisht qëndrimet që mban trupi gjykues lidhur me faktet që janë paraqitur gjatë procesit të rivlerësimit, analizën e provave, si dhe disponimin lidhur me masën disiplinore, në përputhje me nenin 57, pika 4, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, e cila parashikon se pjesa përshkruese-arsyetuese përmban provat dhe arsyet mbi të cilat mbështeten vendimet. Në zbatim të këtij parashikimi ligjor, trupi gjykues vlerëson se Komisioni, në vendim, ka analizuar qëndrimin/shpjegimet e subjektit në lidhje me rezultatet e hetimit administrativ, sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 96/2016 dhe, në përfundim, ka arritur në konkluzionet përkatëse. Për pasojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron.
69. Në lidhje me pretendimin tjetër të subjektit në këtë shkak ankimi, se arsyetimi i vendimit të Komisionit është abuziv dhe alogjik, pasi nuk bazohet në relacionin e rivlerësimit sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, i cili as nuk është përgatitur si i tillë nga relatorja e çështjes, trupi gjykues i Kolegjit, nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni, konstaton se sipas procesverbalit të datës 04.10.2018, “Mbledhje trupe për marrje vendimi lidhur me procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit Ahmet Jangulli”, relatorja e çështjes pasi ka relatuar në trupë në lidhje me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, ka propozuar “papërshtatshmërinë” në bazë të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
70. Trupi gjykues vlerëson se neni 44 i ligjit nr. 84/2016, në paragrafin e parë parashikon se relatori i çështjes përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale, mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve të tjera ligjore dhe bën propozimin për vlerësimin e subjektit të rivlerësimit sipas njërës prej shkronjave “a”, “b” ose “c” të këtij neni. Kjo dispozitë duhet interpretuar në harmoni me nenin 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilës Komisioni i kalon subjektit barrën e provës për të dhënë shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ. Relacioni i relatorit për vlerësimin e aftësive profesionale është pjesë e rezultateve të hetimit administrativ, të cilat në rastin konkret i janë bërë të njohura subjektit. Trupi gjykues arrin në konkluzionin se procesi i vlerësimit të aftësive profesionale, si pjesë e procesit të rivlerësimit të subjektit, është kryer nga Komisioni në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 84/2016.

Sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit është i pabazuar.

71. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se nga katër dokumentet ligjore të paraqitura nga ai, është marrë në analizë vetëm një, në një kohë kur duhet të analizoheshin edhe tri të tjerat, pasi janë dokumente që shërbejnë për të provuar aftësitë profesionale të tij. Konkluzionet e Komisionit në lidhje me vendimin gjyqësor si dokument ligjor i përzgjedhur nga vetë subjekti, për sa i përket kohëzgjatjes së gjykimit të çështjes, janë të pabazuara.*

Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues i Kolegjit, nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit, konstaton se më datë 30.01.2017, subjekti ka dorëzuar pranë KLD-së “Formularin e vetëvlerësimit profesional”, së bashku me dokumentet shoqëruese bashkëlidhur tij. Në pikën 5 të formularit, subjekti ka deklaruar si dokumente ligjore të përzgjedhura prej tij, në kuptim të nenit 3, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, katër dokumente të listuara si në vijim.

1. Vendim nr. {***}, datë 03.04.2014, dosja nr. {***}, datë 24/26.12.2013, me palë: paditës N.H.; të paditur {***}, {***}.

2. Bisedime përfundimtare të paditësit Ahmet Jangulli para Gjykatës së Apelit për masën disiplinore “Vërejtje me paralajmërim”.

3. Ankim i gjyqtarit Ahmet Jangulli kundër projektaktit të vlerësimit profesional të tij për vitet 2007-2009.

4. Trajtim juridik për punën e kryer nga gjyqtari Ahmet Jangulli për vitin 2015.

Komisioni, në vendim²⁸, ka renditur faktin e përzgjedhjes së gabuar të subjektit për çështjet që nuk përmbushnin kriterin e “dokumentit ligjor” të parashikuar në nenin 3, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si një nga faktet e mjaftueshme për ta identifikuar si një magjistrat, i cili ka njohuri, aftësi, gjykim apo sjellje të cekët, një mënyrë/praktikë pune të papajtuësme me pozicionin e tij.

72. Trupi gjykues vlerëson se pika 2 e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 është shumë e qartë në përkufizimin e “dokumentit ligjor”, duke e përcaktuar atë si çdo dokument i përgatitur nga subjekti i rivlerësimit gjatë ushtrimit të detyrës profesionale, në veçanti vendim, raport/relacion, kërkesë për gjykim penal, mendim/opinion ligjor, si dhe akte të tjera që provojnë aftësitë profesionale të tij. Ky përkufizim është përshtatur nga ligjvënësi për të gjithë subjektet e rivlerësimit, në varësi të pozicionit të tyre në sistemin e drejtësisë si gjyqtar, prokuror, apo këshilltar/ndihmës ligjor.

Në zbatim të këtij përkufizimi ligjor, trupi gjykues analizoi dokumentet e pretenduara nga subjekti dhe vlerësoi se akti “Bisedime përfundimtare të paditësit Ahmet Jangulli para Gjykatës së Apelit për masën disiplinore *Vërejtje me paralajmërim*” dhe akti “Ankim i gjyqtarit Ahmet Jangulli kundër projektaktit të vlerësimit profesional të tij për vitet 2007-2009” janë përgatitur nga subjekti në ushtrim të së drejtës së tij të ankimit për të kundërshtuar një masë disiplinore, me interes personal, si palë në një çështje, por jo në ushtrim të detyrës së tij si gjyqtar. Akti “Trajtim juridik për punën e kryer nga gjyqtari Ahmet Jangulli për vitin 2015” është një “Raport analizë për vitin 2015, për punën e kryer dhe problematikën që ka rezultuar në punën e kryer”, ashtu siç vetë subjekti citon në shkresën përcjellëse të kësaj analize, drejtuar KLD-së. Sa më sipër, trupi gjykues çmon se KLD-ja dhe Komisioni me të drejtë nuk kanë marrë në analizë dokumentet e sipërcituara, pasi nuk plotësojnë kriterin e “dokumentit ligjor” të parashikuar në nenin 3, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

73. Në lidhje me pretendimin e subjektit se për vendimin gjyqësor si dokument ligjor i përzgjedhur nga vetë subjekti, në vlerësimin e kohëzgjatjes së gjykimit të çështjes nuk mund të shërbejë standardi i vendosur nga Aneksi 1 i Sistemit të Vlerësimit, pasi ky sistem bën fjalë për një rregullim ligjor para daljes së ligjit nr. 49/2012 dhe lënda konkrete e gjykimit nuk ka qenë lënda administrative për të cilën flet sistemi, trupi gjykues konstaton se Komisioni në vendim ka renditur problematikën e konstatuara nga KLD-ja, në analizimin e përmbajtjes së vendimit nr. {***}, datë 03.04.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, me gjyqtar të vetëm subjektin Ahmet Jangulli, si vijon.

Dosja civile administrative është regjistruar në datën 26.12.2013 dhe gjykimi ka përfunduar në datën 03.04.2014, pas 3 muajsh e 8 ditësh. Kohëzgjatja e gjykimit ka tejkaluar afatin standard njëmuajor të përcaktuar nga shkronja “c” e pikës 5 të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

Vendimi është strukturuar në paragrafë dhe në pjesë, të ndarë me tituj të emërtuar dhe të numërtuar [...]. Teksti në disa raste paraqitet jo i qartë dhe i kuptueshëm.

Trupi gjykues, pas verifikimit të konstatimeve të KLD-së dhe të Komisionit si më sipërcituar, në përgjigje të pretendimit të subjektit, vlerëson se vendimi nr. {***}, datë 14.04.2010, “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve” është një akt i miratuar para hyrjes në fuqi në ligjit nr. 49/2012, por që rezulton të mos jetë shfuqizuar nga KLD-ja me hyrjen në fuqi të këtij ligji, madje ka qenë në fuqi edhe në kohën që subjekti ka shqyrtuar çështjen në fjalë. Vetë ligji nr.

²⁸ *Shih faqen 15 dhe faqen 29 të vendimit nr. 67, datë 05.10.2018, të Komisionit.*

49/2012, neni 3, pika 1 parashikon si një parim themelor zhvillimin e gjykimit administrativ brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme, të cilat janë më të shkurtra në raport me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile.

74. Subjekti pretendon se lënda e gjykimit të çështjes për të cilën është marrë vendimi nr. 201, datë 14.04.2014, nuk është lënda administrative për të cilën flet sistemi, pasi në formë bëhet fjalë për akte administrative dhe kërtime për llogari të tyre, por në themel bëhet fjalë për një konflikt pronësie midis paditësit dhe ndërhyrësit kryesor. Trupi gjykues vlerëson se ky pretendim i subjektit nuk qëndron, pasi çështja e gjykuar nga ai ka pasur si objekt sigurim padie për kundërshtim akti administrativ, si dhe shfuqizim akti administrativ, objekt që është brenda kompetencës së gjykimit administrativ. Gjithashtu, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit bie në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 4, datë 10.12.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë²⁹, i cili ka unifikuar praktikën gjyqësore në lidhje me kompetencën lëndore të gjykatave administrative. Nëse çështja për të cilën gjyqtari ka dhënë vendimin nr. {***}, datë 14.04.2014, nuk do të hynte në lëndën administrative, atëherë subjekti, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm, duhet t'ia kalonte çështjen për shqyrtim gjykatës kompetente.
75. Në lidhje me pretendimin e subjektit se afati njëmuor që kërkon sistemi lidhet me ngarkesën e punës jo më pak se 150 gjykime çështjesh në vit dhe jo me dhjetëfishin apo më shumë ngarkesë siç ka pasur subjekti, trupi gjykues vlerëson se Komisioni i ka dhënë përgjigje të drejtë këtij pretendimi në vendim, duke arsyetuar se edhe gjyqtarë të tjerë me të njëjtën ngarkesë pune i kanë menaxhuar më mirë dosjet e shqyrtuara, duke mos shkaktuar shkelje afatesh si në rastin e subjektit Ahmet Jangulli.
Sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit është i pabazuar.
76. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se konkluzioni i KLD-së dhe i Komisionit, në lidhje me dokumentet e përzgjedhura me short, për sa i përket kohëzgjatjes së gjykimit dhe veprimeve procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit të çështjeve, është i gabuar dhe abuziv.*
Lidhur me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në vendim³⁰, ka renditur konstatimet e KLD-së në raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Ahmet Jangulli për dokumentet e përzgjedhura me short, si vijojnë.
77. Për çështjen civile nr. {***} regj., datë 22.01.2014, që i përket paditësit {***}, kundër të paditurit S.Gj.B., me objekt “Shfuqizimin e pjesshëm të aktit të marrjes së tokës së fshatit {***}, komuna {***}, në emër të S.Gj.B. etj.”, përfunduar me vendimin nr. {***}, datë 21.05.2014:
a) Nuk pasqyrohet veprimi procedural i gjyqtarit për të kaluar nga njëra seancë përgatitore në tjetrën, duke pasur një periudhë 3-mujore pa veprime të dokumentuara. Janë caktuar seanca përgatitore me distancë rreth 1 muaj e gjysmë nga njëra-tjetra.
b) Në dosje gjenden tri vendime për caktimin e seancës përgatitore, të panëshkruara nga gjyqtari. Të tri procesverbalet e seancës përgatitore, të administruara në dosje, janë të paplota, pasi mungojnë disa nga të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera, siç janë gjeneralitetet e të paditurit dhe pasqyrimi i shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ndërgjyqëse. Ndërsa vendimet e ndërmjetme të nxjerra nga gjyqtari me akt të veçantë, janë të panëshkruara prej tij dhe një prej tyre ka edhe pasaktësi në datë.
78. Për çështjen gjyqësore nr. {***} regj., datë 29.01.2014, që i përket paditësit B.K. kundër të paditurit {***}, me objekt “Shfuqizimin e vendimit të KQA nr. {***}, datë 22.11.2013,

²⁹ Në fuqi në kohën e gjykimit të çështjes.

³⁰ Shih faqet 16-17 të vendimit nr. 67, datë 05.10.2018, të Komisionit.

vendimit të KRA nr. 349, datë 24.09.2013, dhe vendimit nr. {***}, datë 28.08.2013, të Degës së Përfitimeve Shkodër, si dhe detyrimin për pension pleqërie”, përfunduar me vendimin nr. {***}, datë 26.06.2014:

a) gjykimi ka zgjatur gjithsej 4 muaj e 28 ditë. Kjo kohëzgjatje, në tejkalim të afatit të përcaktuar nga Aneksi 1 i Sistemit të Vlerësimit, ka ardhur si pasojë e mosorganizimit të mirë të punës nga ana e gjyqtarit, i cili ka zhvilluar seancën e dytë përgatitore pas 4 muajsh nga seanca e parë. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e gjykimit nga subjekti i rivlerësimit nuk respekton standardin e procesit të rregullt ligjor të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së;

b) një nga veprimet e para përgatitore, siç është ai i kthimit për plotësim të të metave të padisë, është kryer nga gjyqtari pas 4 muajsh, në shkelje të nenit 25/1 të ligjit nr. 49/2012, ku parashikohen afate të shpejta e të arsyeshme, brenda 7 ditëve nga data e paraqitjes së padisë. Edhe periudha 4-mujore për t'i njoftuar të paditurit padinë dhe aktet shoqëruese të saj është në shkelje të afatit 10-ditor nga marrja e njoftimit, e parashikuar në nenin 25/1/b të ligjit nr. 49/201;

c) lidhur me kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, në disa raste ato nuk rezultojnë të pasqyruara saktë. Janë caktuar dy seanca përgatitore dhe dy seanca gjyqësore, me distancë rreth 1 muaj e gjysmë nga njëra-tjetra. Një seancë nuk ka qenë produktive (seanca 2), pasi gjyqtari duhet t'i kishte konstatuar të metat e padisë që në seancën e parë;

ç) në dosje gjenden dy vendime për caktimin e seancës përgatitore, të cilat nuk janë të nënshkruara nga gjyqtari. Dosja nuk është sistemuar në mënyrë kronologjike, në referencë të rregullave procedurale civile.

79. Për çështjen gjyqësore nr. {***} regj., datë 31.07.2014, që i përket paditësit E.I. kundër të paditurës {***}, me objekt “Konstatimin e zgjidhjes së kontratës së punës, me efekt të menjëhershëm e pa shkaqe të justifikuara, dëmshpërblimin për zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës etj.”, përfunduar me vendimin nr. {***}, datë 30.09.2015:

a) gjykimi ka zgjatur gjithsej 1 vit e 2 muaj. Kjo kohëzgjatje është jashtë afatit 6-mujor për çështjet civile me palë kundërshtare (*ku përfshihen edhe mosmarrëveshjet e punës*) të përcaktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Në tejkalimin e afatit ka ndikuar mosorganizimi i mirë i punës nga ana e gjyqtarit, i cili ka lënë pa veprime çështjen një vit;

b) gjyqtari nuk ka marrë masat për menaxhimin e çështjes, pasi ka vendosur kthimin e kërkesëpadisë për plotësimin e të metave një vit pas seancës së parë përgatitore, në kundërshtim me parashikimet e nenit 25, shkronja “a” e ligjit nr. 49/2012;

c) nuk pasqyrohet veprimi procedural që ka kryer gjyqtari për të kaluar nga një seancë përgatitore në tjetrën. Po kështu, megjithëse në seancë përgatitore gjyqtari ka lënë 10 ditë afat për ndreqjen e të metave të padisë, seanca gjyqësore është çelur pas 28 ditëve. Janë caktuar dy seanca përgatitore dhe dy seanca gjyqësore, me distancë mbi 4 muaj nga njëra-tjetra;

ç) të gjitha vendimet e gjyqtarit të vetëm, të administruara në dosje, nuk janë të nënshkruara nga gjyqtari, por me “d.v.”;

d) dosja nuk është sistemuar në mënyrë kronologjike, në referencë të rregullave procedurale civile.

80. Për çështjen gjyqësore nr. {***} regj., datë 16.12.2015, që i përket paditësit E.A. kundër të paditurve {***} dhe {***}, me objekt “Shfuqizimin e vendimit nr. {***}, datë 04.12.2015, për shqyrtimin e masës disiplinore “Ulje në gradë 6 muaj, rikthimin e gradës komisar dhe trajtimeve financiare në gjendjen e mëparshme”, e përfunduar me vendimin nr. {***}, datë 13.06.2016:

a) gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Ahmet Jangulli ka zgjatur gjithsej 5 muaj e 28 ditë, jashtë afatit njëmuajor të caktuar nga pika 5, shkronja “c” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Në

tejkalimin e afatit ka ndikuar mosorganizimi i mirë i punës nga ana e gjyqtarit, i cili ka zhvilluar seancën e dytë përgatitore pas 4 muajsh nga seanca e parë, duke kthyer aktet për plotësimin e të metave;

b) gjyqtari ka kërkuar kthimin e padisë dhe të akteve për plotësimin e të metave të padisë pas 4 muajsh, në shkelje të nenit 25/1 të ligjit nr. 49/2012;

c) dosja nuk është sistemuar në mënyrë kronologjike, në referencë të rregullave procedurale civile.

81. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektin barrën e provës, në lidhje me konstatimet e analizës së kryer nga KLD-ja. Subjekti ka dhënë shpjegimet e tij në përgjigje të barrës së provës, shpjegime të cilat i ka përsëritur edhe në shkaqet e ankimit. Trupi gjykues vëren se problematikat e konstatuara nga raporti i KLD-së dhe nga Komisioni janë të ngjashme në të gjitha çështjet e shqyrtuara nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e gjyqtarit dhe argumentet e dhëna nga subjekti në ankim janë të njëjta për secilën nga çështjet. Për këtë arsye, trupi gjykues analizoi shkaqet e ankimit si më poshtë.
82. Në analizë të pretendimit të subjektit se vendimmarrjet për thirrjen e seancës gjyqësore janë nënshkruar nga gjyqtari me “d.v.” që në kompjuter, me një nënshkrim që njihet nga të gjitha shkallët e gjyqësorit, trupi gjykues vlerëson se në nenin 27, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, përcaktohet se: *1. Gjyqtari, pasi sigurohet për kryerjen e të gjitha veprimeve përgatitore, menjëherë nxjerr urdhrin për caktimin e seancës gjyqësore. Ky urdhër ka rëndësi të posaçme në procesin gjyqësor administrativ, pasi sipas pikës 2 të nenit 27 të sipërcituar, ai përmban njoftimin dhe mënyrën e njoftimit të palëve dhe të personave që duhet të marrin pjesë në seancën gjyqësore. Kodi i Procedurës Civile³¹, në nenin 171/a, duke parashikuar se gjykata drejton procesin gjyqësor nëpërmjet vendimeve dhe urdhrave, i ka dhënë të njëjtën rëndësi urdhrin dhe vendimit si akte procedurale. Në zbatim të këtyre dispozitave, subjekti, në kundërshtim me sa pretendon, kishte detyrimin të nënshkruante urdhrin për thirrjen e seancës gjyqësore. Nënshkrimi me “d.v.” i akteve që mbahen në dosjen gjyqësore, nuk gjendet i parashikuar në asnjë dispozitë procedurale të ligjit nr. 49/2012 dhe as në Kodin e Procedurës Civile, në plotësim të tij.*
83. Në lidhje me pretendimin e subjektit se parimisht nuk ka seancë përgatitore vazhduese dhe se çështja e regjistruar qëndron në pritje të gjykimit, trupi gjykues vlerëson se KLD-ja në konstatimet e raportit për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nuk ka përmendur dhe as nuk ka lënë të kuptohet se seancat përgatitore janë vazhduese, por është shprehur për planifikimin në kohë dhe efektivitetin e tyre. Gjyqtari ka vendosur për kthimin e padisë për plotësim të të metave në seancë përgatitore të zhvilluar në afate kohore disamujore pas seancës së parë, në kundërshtim me nenin 25, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 49/2012, i cili përcakton se: *1. Për zhvillimin e gjykimit, sipas parimit të një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme, gjyqtari kryesues, brenda 7 ditëve nga data e paraqitjes së padisë, kryen këto veprime: a) I kërkon paditësit plotësimin e të metave të padisë, duke i caktuar atij një afat, deri në 10 ditë. Kur paditësi nuk plotëson të metat e padisë, brenda afatit të caktuar, gjyqtari jep vendim për kthimin e padisë dhe të akteve që i bashkëlidhen asaj. Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë”.*
- Ndërsa konceptin e “pritjes së çështjes për gjykim” të pretenduar nga subjekti, trupi gjykues nuk e gjen të referuar në asnjë nga dispozitatat procedurale të ligjit nr. 49/2012 dhe të Kodit të Procedurës Civile.
84. Në lidhje me pretendimin e subjektit se afati njëmuor që kërkon sistemi lidhet me ngarkesën e punës jo më pak se 150 gjykime çështjesh në vit dhe jo me dhjetëfishin apo më shumë ngarkesë siç ka pasur subjekti, trupi gjykues vlerëson se Komisioni i ka dhënë përgjigje të

³¹ Ligji i kohës.

drejtë këtij pretendimi në vendim, duke arsyetuar se edhe gjyqtarë të tjerë me të njëjtën ngarkesë pune i kanë menaxhuar më mirë dosjet e shqyrtuara, duke mos shkaktuar shkelje afatesh si në rastin e subjektit Ahmet Jangulli.

Sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se konkluzionet e Komisionit për secilën nga çështjet/dokumentet ligjore të analizuarra janë të drejta dhe, për rrjedhojë, pretendimi i subjektit përkundër tyre është i pabazuar.

85. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se konkluzioni i Komisionit në lidhje me dokumentin nr. 2 të përzgjedhur me short, është i gabuar, pasi afati 5-ditor që përcakton Kodi i Procedurës Civile për gjykimin për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit konsumohet deri te veprimet e regjistrimit në gjykatë, pa u paraqitur akoma çështja para gjyqtarit, prandaj jo më kot është hequr fare tashmë nga ligjvënësi. Duke zbritur kohën gjatë së cilës çështja e regjistruar ka qëndruar në pritje të gjykimit, gjykimi ka zgjatur për 7 ditë, në kohën më minimale të mundshme.*

Lidhur me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në vendim³², ka renditur konstatimet e KLD-së në raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Ahmet Jangulli për dokumentin nr. 2 të përzgjedhur me short, i cili është çështja gjyqësore nr. {***} regj., datë 08.06.2016, që i përket kërkuarit {***}, dega Shkodër, me objekt “Lëshim urdhri ekzekutimi”, përfunduar me vendimin nr. {***}, datë 29.06.2016, si vijon.

a) Dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, janë depozituar nga gjyqtari Ahmet Jangulli në sekretari në datën 30.07.2014 – pas 1 muaji e 1 dite nga shpallja, tej afatit 7-ditor të përcaktuar në nenin 42, pika 3 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

b) Gjykimi nga gjyqtari Ahmet Jangulli, ka zgjatur 21 ditë, tej afatit 5-ditor të caktuar nga neni 511, shkronja “ç” e Kodit të Procedurës Civile, pasi gjyqtari nuk ka marrë masat për menaxhimin e çështjes, për të caktuar seancën gjyqësore brenda afatit 5-ditor të parashikuar në nenin 511 “Urdhri i ekzekutimit” të Kodit të Procedurës Civile. Seanca për lëshimin e urdhrit është caktuar pas 21 ditëve. Është caktuar vetëm 1 seancë gjyqësore, e cila ka qenë produktive, ku gjyqtari, pasi ka shqyrtuar çështjen, ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit.

c) Urdhri i gjyqtarit për caktimin e seancës gjyqësore është i panënshkruar.

Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës, në lidhje me konstatimet e analizës së kryer nga KLD-ja. Subjekti ka dhënë shpjegimet e tij në përgjigje të barrës së provës, shpjegime të cilat i ka përsëritur edhe në shkaqet e ankimit.

86. Në analizë të pretendimit të subjektit se dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar është depozituar në sekretari më datë 30.06.2014 dhe jo më 30.07.2014, siç konstaton raporti i KLD-së, pasi data e fundit ka qenë një lapsus i sekretarisë gjyqësore, trupi gjykues konstaton se subjekti, gjatë hetimit, bashkëlidhur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ, ka paraqitur prova për të vërtetuar këtë pretendim. Sipas shkresës “Sqarim”, datë 19.09.2018, të kancelares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, dosja nr. {***}, me datë vendimi 29.06.2016, është dorëzuar në sekretari më datë 30.06.2016. Regjistrimi në regjistër me datë dorëzimi 30.07.2016, ka qenë një gabim njerëzor i sekretarisë gjyqësore, për shkak të ngarkesës së lartë të punës në gjykatë. Bashkëlidhur shkresës janë përcjellë edhe fletët e regjistrimit manual dhe printimi i regjistrimit elektronik, të cilët konfirmojnë gabimin njerëzor të sekretarisë gjyqësore. Trupi gjykues vlerëson se këto akte provojnë se gjyqtari e ka dorëzuar dosjen në sekretarinë e gjykatës në datën e pretenduar prej tij.

87. Lidhur me pretendimin e subjektit se duke zbritur kohën gjatë së cilës çështja e regjistruar ka qëndruar në pritje të gjykimit, gjykimi ka zgjatur për 7 ditë, në kohën më minimale të mundshme, trupi gjykues i Kolegjit, nga verifikimi i akteve procedurale të çështjes nr. {***},

³² Shih faqet 16-17 të vendimit nr. 67, datë 05.10.2018, të Komisionit.

me datë regjistrimi 08.06.2016, konstaton se çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër në datën 08.06.2016. Me shortin elektronik të zhvilluar në datën 08.06.2016, çështja i është caktuar për gjykim gjyqtarit Ahmet Jangulli. Me urdhrin “Për caktimin e seancës gjyqësore”, të datës 13.06.2016, gjyqtari ka kaluar çështjen në seancë gjyqësore më datë 29.06.2016, ora 10:00, duke urdhëruar njoftimin e kërkesit. Në seancën gjyqësore të datës 29.06.2016, gjyqtari i vetëm ka përfunduar hetimin gjyqësor, bisedimet përfundimtare dhe është tërhequr për vendim. Në kthim ka shpallur vendimin nr. {***}, datë 29.06.2016, për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit. Gjykimi nga gjyqtari ka zgjatur për 21 ditë, nga data 08.06.2016, e cila është data e regjistrimit të çështjes/kërkesës së kreditorit për lëshimin e urdhrit, deri në datën 29.06.2016, e cila është data e dhënies së vendimit. Trupi gjykues vlerëson se kohëzgjatja e shqyrtimit të çështjes nga subjekti i rivlerësimit është në kundërshtim me nenin 511, shkronja “ç” e Kodit të Procedurës Civile, e cila parashikon se: “Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim nëpërmjet lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, i cili: ç) për rastet e parashikuara nga shkronjat “d”, “dh” dhe “e”, lëshohet nga gjykata e vendit ku detyrimet që përmban titulli ekzekutiv do të përmbushen brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së kreditorit”.

88. Në lidhje me pretendimin e subjektit se afati 5-ditor që përcakton Kodi i Procedurës Civile për gjykimin për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit konsumohet deri te veprimet e regjistrimit në gjykatë pa u paraqitur akoma çështja para gjyqtarit, prandaj jo më kot është hequr fare tashmë nga ligjvënësi, trupi gjykues i Kolegjit, nga verifikimi i akteve të fashikullit gjyqësor të çështjes nr. {***}, datë 08.06.2016, konstaton se nga të dhënat e sistemit elektronik të regjistrimit të çështjeve, rezulton se kërkesa për lëshim urdhër ekzekutimi është paraqitur në gjykatë nga {***}, dega rajonale Shkodër, më datë 07.06.2016, dhe shorti elektronik për caktimin e gjyqtarit është hedhur më datë 08.06.2016. Në kundërshtim me sa pretendon subjekti, sekretaria gjyqësore nuk ka konsumuar afatin ligjor 5-ditor për shqyrtimin e kërkesës. Me ndryshimet ligjore të mëvonshme që i janë bërë Kodit të Procedurës Civile, neni 511/1 është shfuqizuar, por gjyqtari është i detyruar të zgjidhë mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, të detyrueshme për zbatim prej tij³³.

Sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se konkluzionet e Komisionit për dokumentin ligjor nr. 2 të përzgjedhur me short janë të drejta dhe, për rrjedhojë, pretendimi i subjektit përkundër tyre është i pabazuar.

89. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se për praktikën e procedimit disiplinor të vitit 2018 nuk është njoftuar për ndonjë procedim disiplinor ndaj tij dhe, për rrjedhojë, as për të drejtat që ka pasur në kuadër të këtij procedimi. Inspektorati i KLD-së ka kryer verifikim për gjëra që zgjidhen vetëm nëpërmjet apelimit gjyqësor. Ministri i Drejtësisë nuk mund të vlerësonte materialin e Inspektoratit të KLD-së nëse kishte vend apo jo për fillimin e procedimit disiplinor, sepse kjo nuk është parashikuar në tagrat e saj ligjore. Ministri i Drejtësisë në propozimin e masës disiplinore dhe Inspektorati i KLD-së në raportin e tij kanë arritur në rezultatin se subjekti ka zvarritur gjykimet, në vlerësim të gabuar të veprimeve të tij në cilësinë e gjyqtarit. Në analizë të këtij shkakut ankimi, nga verifikimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ nga Komisioni, trupi gjykues konstaton situatën faktike si vijon. Në raportin për analizimin e aftësisë profesionale, në rubrikën “Të dhëna nga burime arkivore të KLD-së”, KLD-ja ka konstatuar se një ankesë e vitit 2015 ndaj gjyqtarit Ahmet Jangulli është verifikuar për zvarritje gjykimi dhe shkelje formale të dispozitave procedurale. Në përfundim, është konstatuar zvarritje në gjykimin e pesë çështjeve gjyqësore dhe relacioni i është dërguar ministrit të Drejtësisë për të vlerësuar mundësinë e fillimit të procedimit disiplinor të gjyqtarit.*

³³ Neni 16, fjalia e parë e Kodit të Procedurës Civile parashikon: “Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj”.

90. KLD-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 15.05.2018, ka përcjellë në Komision shkresën e ministrit të Drejtësisë nr. {***} prot., datë 21.02.2018, me lëndë “Propozim për marrjen e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” ndaj gjyqtarit Ahmet Jangulli”, së bashku me dokumentacionin shoqërues, sipas së cilës Drejtoria e Policisë së Shtetit, me shkresën nr. {***} port., datë 06.01.2016, i ka drejtuar ankesë KLD-së për verifikimin e ligjshmërisë së disa veprimeve procedurale të kryera nga gjyqtari Ahmet Jangulli i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Ankuesi paraqet fakte se gjyqtari nuk ka respektuar Kodin e Procedurës Civile dhe Kodin Civil, në lidhje me pesë çështje që ka pasur në shqyrtim. Shkeljet e pretenduara nga ankuesi kanë të bëjnë me shkelje procedurale të afateve, si dhe me mospranimin e përfaqësuesit me autorizim të palës së paditur Drejtorisë së Policisë së Shtetit, duke sjellë si pasojë zvarritjen e gjykimit të çështjeve administrative, të regjistruara në këtë gjykatë. Inspektorët e KLD-së, të ngarkuar për verifikimin e ankesës me anë të urdhrin të verifikimit nr. {***} prot., datë 04.03.2016, të Kryeinspektorit të KLD-së kanë vënë në dijeni gjyqtarin Ahmet Jangulli për urdhrin e verifikimit, nëpërmjet aktit të njoftimit me nr. {***} port., datë 09.03.2016. Akti i njoftimit i sipërcituar është nënshkruar nga gjyqtari Ahmet Jangulli, kryetarja e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe nga inspektorët. Gjyqtari Jangulli u ka dhënë inspektorëve deklaratimet e tij, të cilat janë pasqyruar në aktin “Procesverbal për pasqyrimin e veprimit të verifikimit (deklarimet e gjyqtarit Ahmet Jangulli)”, datë 09.03.2016, i nënshkruar nga gjyqtari dhe inspektorët. Në përfundim të verifikimit, inspektorët e KLD-së kanë hartuar raportin përkatës më datë 26.04.2017, i cili më datë 16.01.2018 i është përcjellë Ministrisë së Drejtësisë. Gjyqtari Jangulli, me aktin e njoftimit nr. {***} prot., datë 26.02.2018, është njoftuar nga KLD-ja se ministri i Drejtësisë me shkresën nr. {***} prot., datë 21.02.2018, ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor ndaj tij dhe i ka vënë në dispozicion dokumentacionin shoqërues. Në këtë akt njoftimi, gjyqtari ka deklaruar se i është garantuar e drejta procedurale e parashikuar nga ligji. Akti i njoftimit është nënshkruar nga gjyqtari Jangulli dhe inspektor Piro Samara. Në shkresën nr. {***} prot., datë 15.05.2018, KLD-ja informon Komisionin se kërkesa e ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor të gjyqtarit Jangulli ishte përfshirë për shqyrtim në mbledhjen e KLD-së të datës 07.05.2018, por shqyrtimi i saj u shty për mbledhjen e radhës, për shkak se gjyqtari kishte bërë me dije pamundësinë për të marrë pjesë në mbledhje.
91. Nga analiza e situatës faktike si më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka qenë në dijeni të plotë të procedimit disiplinor, ka dhënë deklaratimet gjatë verifikimit të ankesës, ka marrë dijeni dhe i është vënë në dispozicion dokumentacioni i kërkesës për procedimin disiplinor dhe ai vetë ka pranuar se i është garantuar e drejta procedurale. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se pretendimi i subjektit që nuk është njoftuar për ndonjë procedim disiplinor ndaj tij të vitit 2018 dhe, për rrjedhojë, as për të drejtat që ka në kuadër të këtij procedimi, është i pabazuar.
92. Në lidhje me pretendimin e subjektit në ankim se nga njëra anë Inspektorati i KLD-së ka trajtuar se ankesa është një gjë që zgjidhet nëpërmjet apelimit gjyqësor dhe, nga ana tjetër, ka kryer verifikim për gjëra që nuk mund të verifikohen prej tij, por mund të zgjidhen vetëm nëpërmjet apelimit gjyqësor, trupi gjykues konstaton se në relacionin e datës 26.04.2017, Inspektorati i KLD-së ka arritur në këto konkluzione: *Për gjyqtarin Ahmet Jangulli, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, lidhur me ankesën e bërë nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, në pesë raste të gjykuara prej tij, sugjerohet: A. Lidhur me ankesën për mospranimin e përfaqësuesve të caktuar me autorizim nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, ankesa duhet të arkivohet, pasi kjo ankesë i përket shqyrtimit gjyqësor. B. Lidhur me ankesën për zvarritje, konstatohet se ka zvarritje të gjykimit në pesë rastet e analizuara, prandaj duhet vendosur:*

Dërgimi i relacionit dhe akteve të tjera pranë Ministrisë së Drejtësisë, për fillimin e procedimit disiplinor për gjyqtarin Ahmet Jangulli.

93. Duke analizuar këto konkluzione në raport me kuadrin ligjor të kohës, trupi gjykues vlerëson se Inspektorati i KLD-së ka vepruar brenda kompetencave që i ka njohur ligji nr. 8811, datë 17.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së”, i ndryshuar, i cili në nenin 16, pika 1, shkronja “a” parashikon se: *Inspektorati i KLD-së ka si detyrë të verifikojë ose t’i dërgojë ministrit të Drejtësisë për trajtim ankesat e shtetasve dhe të subjekteve të tjera që i drejtohen Këshillit të Lartë të Drejtësisë për veprime të gjyqtarëve, të vlerësuara në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës. Inspektorati verifikon vetëm ato ankesa të cilat nuk mund të zgjidhen nëpërmjet apelimit gjyqësor ose për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues. Verifikon ankesat e shtetasve dhe të subjekteve të tjera drejtuar ministrit të Drejtësisë, të cilat gjykohen prej tij për t’u ndjekur nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Gjithashtu, Inspektorati ka vepruar edhe në përputhje me parashikimet e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së”³⁴, e cila në nenin 24, pika 1, shkronja “b” parashikon se objekt i verifikimit të ankesave mund të jenë: *Faktet apo rrethanat që mund të konsiderohen shkelje në referim të detyrave gjyqësore të gjyqtarit, të cilat përgjithësisht kanë të bëjnë me mosrespektimin formal të ligjit, me mosrespektimin e solemnitetit gjatë gjykimit, me planifikimin dhe organizimin e punës, si dhe me sjelljen e gjyqtarit gjatë apo jashtë gjykimit, që nga ana tjetër kanë ndikuar apo tregojnë dukshëm për zvarritje të pajustificuar të procesit, mungesë të etikës profesionale në komunikim, mungesë të kujdesit në motivim ligjor të vendimit gjyqësor apo për një mënyrë të vepruari me pasoja për palët në proces gjyqësor. Ndërsa në pikën 2, shkronja “a” e po këtij neni përcaktohet se: *Nuk përbëjnë objekt verifikimi të ankesave: a. pretendimet për fakte apo rrethana që mund të zgjidhen nëpërmjet kontrollit gjyqësor mbi apelimin gjyqësor të palëve, çka nënkupton se nuk përfshihen në objektin e verifikimit ato fakte apo rrethana të parashtruara që kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e ligjit në një rast konkret nga ana e gjyqtarit.***
94. Trupi gjykues vlerëson se verifikimi i ankesës së Drejtorisë së Policisë së Shtetit është kryer nga inspektorët përkatës në përputhje me objektin e përcaktuar në urdhrin e verifikimit nr. {***} prot., datë 04.03.2016, të Kryeinspektorit të KLD-së, e cila ka urdhëruar verifikimin e ankesës ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarit, si dhe evidentimin e çdo të dhëne që lidhet me përmbajtjen e ankesës, ato që tregojnë shkelje me pasojë përgjegjësive disiplinore të gjyqtarit, apo të dhëna për vlerësimin e tij profesional. Por, pavarësisht objektit të këtij urdhri, neni 24 i rregullores së sipërcituar i detyronte inspektorët që në çdo rast, pavarësisht nga detyrat e lëna në urdhrin e verifikimit, të verifikonin vërtetësinë e pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues, si dhe kryesisht çdo çështje që lidhet me funksionimin apo veprimtarinë normale të gjyqtarit, që është e dukshme dhe që mund të konsiderohet nga ligji si shkelje discipline. Në rastin konkret, megjithëse objekti kryesor i ankesës së Drejtorisë së Policisë së Shtetit është shkelja e rëndë e normave procedurale nga gjyqtari Jangulli, në lidhje me përfaqësimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, inspektorët kanë pasur detyrimin ligjor për verifikimin e çdo çështjeje që lidhet me funksionimin apo veprimtarinë normale të gjyqtarit Jangulli. Verifikimi nga Inspektorati i KLD-së ka pasur si objekt vetëm pesë çështjet e trajtuara në ankesën e Drejtorisë së Policisë së Shtetit dhe relacioni përmban të dhëna vetëm për këto pesë çështje. Në mbështetje të analizës si më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se në kundërshtim me sa pretendon subjekti, Inspektorati i KLD-së ka kryer verifikimin e ankesës dhe, në përfundim, me të drejtë ka konkluduar se çështja që i përket apelimit gjyqësor duhet të arkivohet. Po ashtu, konkluzioni tjetër i Inspektoratit se ka zvarritje të gjykimit, dhe për këtë arsye duhet dërguar relacioni dhe aktet të tjera pranë Ministrisë së Drejtësisë, për fillimin e

³⁴ *Miraturar me vendimin nr. 195/2/a, datë 05.07.2006 dhe ndryshuar me vendimin nr. 207/1, datë 07.02.2007, si dhe vendimin nr. 55, datë 28.05.2014 të KLD-së.*

procedimit disiplinor për gjyqtarin, është i drejtë, pasi “zvarritja e gjykimit” nuk i përket shqyrtimit gjyqësor.

95. Në lidhje me pretendimin e subjektit se KLD-ja i ka kërkuar ministrit të Drejtësisë të vlerësojë relacionin nëse kishte vend apo jo për fillimin e procedimit disiplinor, në kundërshtim me ligjin në fuqi, pasi kjo gjë nuk parashikohet në tagrat e ministrit të Drejtësisë, trupi gjykues vlerëson se ligji nr. 96/2016 është legjisllacioni i zbatueshëm për përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve. Ky ligj, i cili ka hyrë në fuqi më datë 22 nëntor 2016, në dispozitën kalimtare, nenin 160, pika 1, shkronja “c” parashikon se deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe inspektoratet ekzistuese do të vazhdojnë të ushtrojnë kompetencat për vendosjen e masave disiplinore, me propozim të ministrit të Drejtësisë, bazuar në procedurën dhe kriteret që parashikohen në pjesën V, kreu I i këtij ligji. Trupi gjykues, mbështetur në legjisllacionin e sipërcituar dhe duke mbajtur në konsideratë faktin se urdhri i verifikimit i Kryeinspektorit të KLD-së për ankesën e Drejtorisë së Policisë së Shtetit ndaj detyrave gjyqësore të gjyqtarit Ahmet Jangulli, mban datën 04.03.2016, si dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor është krijuar më datë 20.12.2018³⁵, vlerëson se për shqyrtimin e pretendimit të subjektit duhet t’i drejtohet ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të nxjerra nga KLD-ja në zbatim të këtij ligji, i cili ka qenë ligji i zbatueshëm për procedimin disiplinor të gjyqtarit Jangulli. Trupi gjykues në këtë vlerësim mbështetet edhe në qëndrimin që ka mbajtur Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 34/2017, në lidhje me kompetencën e ministrit të Drejtësisë për iniciimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve, duke arsyetuar se KLD-ja dhe organet e tjera ekzistuese kushtetuese do të vazhdojnë të ushtrojnë funksionet e tyre deri në konstituimin e plotë të organeve të reja kushtetuese³⁶. Ligji nr. 8811, datë 17.5.2001, në nenin 16, pika 1 shkronja “c” përcakton se në rastin kur vërehen shkaqe ligjore për procedimin disiplinor, relacioni shpjegues dhe dokumentacioni përkatës, nëpërmjet zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i dërgohen menjëherë ministrit të Drejtësisë për të gjykuar për procedimin disiplinor. Mbështetur në sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se ministri i Drejtësisë ka qenë i legjitimuar si nga pikëpamja procedurale, ashtu edhe nga pikëpamja materiale për veprimet e kryera në lidhje me propozimin për procedimin disiplinor të gjyqtarit Ahmet Jangulli dhe, për këtë arsye, pretendimi i subjektit për të kundërtën është i pabazuar.
96. Subjekti në ankim, në kundërshtim të konkluzionit të arritur nga Inspektorati i KLD-së se ka pasur zvarritje të gjykimit në të pesta çështjet objekt ankese, pretendon se veprimet e tij për legalizimin e regjistrimit të çështjes dhe formimit të dosjes, të kryera në seancë përgatitore, vlerësuesit i kanë konsideruar si planifikim të seancave përgatitore në distanca shumë të gjata kohore. Subjekti pretendon se vlerësuesit trajtojnë në heshtje sikur veprimet procedurale duhet të kryhen me palë të thirrura dhe seancat përgatitore duhet të jenë në vazhdimësi. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues vlerëson se Kodi i Procedurës Civile³⁷, në nenin 158 “Regjistrimi i padisë dhe formimi i dosjes”, parashikon se me depozitimin e padisë në sekretari, bëhet regjistrimi i saj në regjistrin themeltar përkatës dhe hapet dosja, në të cilën depozitohen

³⁵ Sipas vendimit nr. 4, datë 20.12.2018, “Mbi deklarin e krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor” të KLGJ-së.

³⁶ Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 34/2017, ka arsyetuar se: “Megjithatë, Gjykata vlerëson se ky konstatim nuk mund të konsiderohet se përbën ometim kushtetues, pasi formulimi i pikës 5 të nenit 179 të Kushtetutës se “anëtarët e KLD-së e përfundojnë mandatin e tyre pas krijimit të KLGJ-së, por jo më vonë se zgjedhja e të gjithë anëtarëve të KLGJ-së, sipas ligjit”, shpreh dhe synon të sigurojë vlerën kushtetuese të vazhdimësisë dhe koherencës institucionale, për rrjedhojë, funksionimin normal të KLD-së në periudhën kalimtare. Për sa kohë vullneti i kushtetutëbërësit ka qenë që të mos ndërpritet funksioni i KLD-së, Gjykata vlerëson se KLD-ja ashtu si edhe organet e tjera ekzistuese kushtetuese do të vazhdojnë të ushtrojnë funksionet e tyre deri në konstituimin e plotë të organeve të reja kushtetuese dhe, në këtë kuptim, zbatimi i neneve 160/1 dhe 173/1 të ligjit duhet të jetë në përputhje të plotë me këtë interpretim të Gjykatës, në respekt të frymës së Kushtetutës”.

³⁷ Legjisllacioni i kohës kur është zhvilluar gjykimi i çështjeve.

padia, akti i njoftimit të saj të paditurve dhe pjesëmarrësve të tjerë në proces, provat shkresore dhe çdo dokument që palët kanë paraqitur lidhur me çështjen në gjykim. Në asnjë dispozitë të tij, Kodi nuk parashikon që regjistrimi i çështjes nga sekretaria gjyqësore duhet të legalizohet nga gjyqtari i caktuar për gjykimin e çështjes. Neni 25, “Veprimet përgatitore”, i ligjit nr. 49/2012 dhe neni 158/a, “Veprimet përgatitore”, i Kodit të Procedurës Civile në plotësim të tij, përcaktojnë veprimet që kryen gjyqtari në seancë përgatitore, por nuk parashikojnë në asnjë rast regjistrimin e çështjes dhe formimin e dosjes nga gjyqtari, aq më tepër në një seancë të posaçme përgatitore, siç pretendon subjekti.

97. Nga verifikimi i procesverbaleve të seancave gjyqësore për secilën prej pesë çështjeve të shqyrtuara nga subjekti i rivlerësimit, objekt verifikimi nga Inspektorati i KLD-së mbi bazën e ankesës së Drejtorisë së Policisë së Shtetit, trupi gjykues konstaton se në çështjen e regjistruar me nr. {***}, datë 06.03.2015, me paditës shoqëria “{***}” ShPK, periudha mes seancës së parë përgatitore dhe seancës së dytë të caktuar nga gjyqtari është 5 muaj dhe 8 ditë. Në çështjen e regjistruar me nr. {***}, datë 27.04.2015, me paditës E.C., periudha mes seancës së parë përgatitore dhe seancës së dytë të caktuar nga gjyqtari është 6 muaj. Në çështjen e regjistruar me nr. {***}, datë 27.04.2015, me paditës B.B., periudha mes seancës së parë përgatitore dhe seancës së dytë të caktuar nga gjyqtari është 5 muaj e 18 ditë. Në çështjen e regjistruar me nr. {***}, datë 13.06.2014, me paditës Gj.D., periudha mes seancës së parë përgatitore dhe seancës së dytë të caktuar nga gjyqtari është 10 muaj. Në çështjen e regjistruar me nr. {***}, datë 18.07.2015, me paditës F.B., periudha mes seancës së parë përgatitore dhe seancës së dytë të caktuar nga gjyqtari është rreth 1 vit.

Subjekti i rivlerësimit, në çdo çështje, në seancën e parë përgatitore i ka caktuar të paditurit një afat prej 7 ditësh për depozitimin në sekretari të prapësimeve me shkrim, listës së personave që kërkon të thirren në gjykim apo të ekspertit, si dhe aktet e plota shkresore. Trupi gjykues konstaton gjithashtu se veprimet procedurale të kryera nga gjyqtari në seancën e dytë gjyqësore, e planifikuar në distancë kohore të largët nga seanca e parë, janë veprime që, bazuar në dispozitat procedurale, kryhen në seancë përgatitore. Konkretisht, në çështjen nr. {***}, datë 27.04.2015, me paditës E.C., në seancën e dytë të zhvilluar pas 6 muajsh nga seanca e parë, gjyqtari, nisur nga gjendja e akteve, çmon se duhet ndërprerë procesi, për të kthyer kërkesë padinë për plotësim të të metave. Trupi gjykues çmon se subjekti ka vepruar në kundërshtim me sa parashikon neni 25, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 49/2012³⁸.

98. Për sa më sipër, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit të mbështetur në relacionin e Inspektoratit të KLD-së se subjekti i rivlerësimit, duke mos kryer veprimet procedurale të parashikuara për seancën përgatitore, por duke i kryer ato në seancat vijuese, ka kryer disa seanca në të cilat janë kryer veprimet përgatitore dhe distanca e largët e planifikimit të tyre ka sjellë zvarritjen e procesit.

Trupi gjykues, nga verifikimi i procesverbaleve të seancave gjyqësore të çështjeve objekt shqyrtimi, konstaton se edhe pas përfundimit të seancave përgatitore, subjekti ka planifikuar seancat gjyqësore në distanca kohore të largëta nga njëra-tjetra, të cilat variojnë nga 1 muaj deri në 3 muaj, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 27, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, i cili parashikon se gjyqtari, pasi sigurohet për kryerjen e të gjitha veprimeve përgatitore, menjëherë nxjerr urdhrin për caktimin e seancës gjyqësore. Afati për zhvillimin e seancës gjyqësore nuk mund të jetë më i gjatë se 15 ditë.

³⁸ Neni 25, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 49/2012 përcakton se: “1. Për zhvillimin e gjykimit, sipas parimit të një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme, gjyqtari kryesues, brenda 7 ditëve nga data e paraqitjes së padisë, kryen këto veprime: a) I kërkon paditësit plotësimin e të metave të padisë, duke i caktuar atij një afat, deri në 10 ditë. Kur paditësi nuk plotëson të metat e padisë, brenda afatit të caktuar, gjyqtari jep vendim për kthimin e padisë dhe të akteve, që i bashkëlidhen asaj. Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë”.

Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit është i pabazuar.

99. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vlerësimi i Komisionit dhe i KLD-së, në lidhje me kriteret e vlerësimit profesional, është abuziv, pasi arsyetimi për faktet që trajton nuk referon gjëkund as në çështje dhe nuk analizon veprimet procedurale të kryera nga subjekti, duke mos cituar asnjë rast dhe asnjë koncept procedural.*

Në analizë të këtij pretendimit të subjektit, trupi gjykues konstaton se KLD-ja, konstatimet e veta në raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, të cilat janë gjetur të drejta edhe nga relatori i çështjes dhe trupi gjykues i Komisionit, i ka mbështetur në rishikimin e pesë dosjeve të çështjeve gjyqësore të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, të përzgjedhura me shortin e datës 28.12.2017 dhe dosjes së një çështjeje gjyqësore të përzgjedhur nga vetë subjekti i rivlerësimit. Këto dokumente janë analizuar në mënyrë të hollësishme, duke përshkruar të gjitha veprimet procedurale të kryera nga subjekti në cilësinë e gjyqtarit, në bazë të të cilave është arritur në konstatimet përkatëse. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, në seancë dëgjimore dhe në ankim, ka kundërshtuar pikërisht këto konstatime të KLD-së për çdo veprim procedural të secilës çështje të analizuar. Trupi gjykues vlerëson se Komisioni, në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit, ka vepruar në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 84/2016, ligjit nr. 96/2016, si dhe të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, i cili shprehet se: “Organi përkatës i vlerësimit të aftësive profesionale rishikon dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi dhe, në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, i cili i paraqitet KPK-së. Në përfundim, sipas nenit 44, relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale, mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë etj., si dhe propozon për subjektin e rivlerësimit nëse është i aftë, me mangësi ose i papërshtatshëm”.

Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit është i pabazuar.

100. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se në dhënien e masës disiplinore, Komisioni ka arritur në një çmim jokushtetues, pasi në një qëndrim kushtetues, problematikat sipas arsyetimit të Komisionit do të duhej të konsideroheshin mangësi profesionale dhe të zbatoheshin prezumimi në favor të masës disiplinore të pezullimit. Referenca ligjore të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 nuk parashikon asgjë për llogaritjen e arritjes së përfundimit “i papërshtatshëm” nga vlerësimi i aftësive profesionale, pasi ajo parashikon një nga kushtet për të dhënë masën, por nuk shpjegon arsyet e marrjes së masës disiplinore.*

Në lidhje me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues vlerëson se Komisioni ka bërë vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit, bazuar në aktet e mbledhura gjatë hetimit administrativ. Komisioni, në vlerësimin e tij, është mbështetur në raportin e hartuar nga organi ndihmës, në përputhje me parashikimin e nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 43 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, në të cilat është përcaktuar qartë mënyra e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit dhe vlera provuese e raportit të KLD-së. Konkluzionet e Komisionit në vendim janë bazuar në mangësitë e konstatuara nga analiza e dokumenteve ligjore të hartuara nga subjekti i rivlerësimit. Komisioni, në kundërshtim me sa pretendon subjekti, në arritjen e konkluzionit për këtë kriter vlerësimi, ka cituar si bazë ligjore nenin E, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe nenet 44 e 59 të ligjit nr. 84/2016.

Trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit se subjekti, në zbatim të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, rezulton “i papërshtatshëm” nga vlerësimi i aftësive profesionale, është i drejtë, pasi mangësitë e konstatuara në shqyrtimin e çështjeve gjyqësore kanë qenë të pranishme në të gjitha dokumentet ligjore të analizuara, të cilat kanë pasur si pasojë kryesore zvarritjen e gjykimit dhe shkeljen e parimeve themelore të procesit të rregullt ligjor nga subjekti i rivlerësimit.

Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit është i pabazuar.

D) Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për denoncimin e publikut dhe shkaqet e ankimit lidhur me të

101. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se arsyetimi dhe përfundimi i Komisionit në lidhje me denoncimin e paraqitur nga publiku për shkeljen e rregullave të etikës, nuk gjen vend në rezultatet e hetimit administrativ dhe, për rrjedhojë, nuk gjen vend as në shpjegimet e subjektit përkundër tyre. Subjekti nuk është njohur me CD-në e cituar në vendim dhe në këtë të fundit nuk trajtohet fare se çfarë konkretisht ka thënë subjekti, duke e vënë atë në pamundësi të japë argumente mbi sjelljet e tij të papërshtatshme. Arsyetimi i Komisionit është joligjor, pasi vlerësimi nuk është brenda periudhës së rivlerësimit, në zbatim të nenit 3, pika 12 për nenin 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

Në analizë të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në vendim³⁹, ka arritur në konkluzionin se komunikimi i subjektit i konstatuar në CD-në e denoncuesit, e identifikon atë si një magjistrat me sjellje të papërshtatshme që dëmton figurën e tij.

Nga verifikimi i materialeve të dosjes së hetimit administrativ, Kolegji konstaton se në të gjendet dokumenti “Formulari i denoncimit nga publiku” prej 2 fletësh, i shtetasit S.Sh.K., për subjektin e rivlerësimit Ahmet Jangulli, për kriterin e aftësive profesionale, me objekt: “Shkelje e etikës profesionale, zvarritje në proces”. Denoncuesi ka sqaruar se shkeljet e etikës profesionale dhe zvarritjet në proces pasqyrohen në çështjen me palë paditëse S.K. dhe palë e paditur {***}, për të cilën gjyqtari ka dhënë vendimin nr. {***}, datë 26.06.2018. Gjithashtu, denoncuesi shprehet se: “Nga kasete bashkëngjitur këtij vendimi, dalin qartë shprehjet tepër ofenduese që dalin nga goja e këtij gjyqtari në adresën time, si “të hedh nga dritarja” etj. Po bashkëngjis këto dokumente: kasetën e tërhequr nga sekretaria e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër”. Bashkëlidhur denoncimit, trupi gjykues konstaton se gjendet një CD, e cila përmban audion e seancës gjyqësore të pretenduar nga denoncuesi.

102. Në analizë të pretendimit të subjektit, trupi gjykues konstaton gjithashtu se në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni e ka njoftuar subjektin se pranë Komisionit është paraqitur denoncimi nr. {***}, datë 12.09.2018, me objekt: “Shkelje etiko-profesionale e zvarritje në proces”. Komisioni i ka referuar subjektit se audio e seancës gjyqësore në të cilën mbështetej denoncimi i shtetasit S.K., është pjesë e dokumentacionit të dosjes së rivlerësimit, si dhe i ka kërkuar të japë shpjegimet për sa rezulton.

Subjekti, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, nuk ka ngritur pretendimin për mungesën e audios bashkëlidhur denoncimit të shtetasit S.K. Në këto shpjegime, subjekti ka dhënë hollësi për çështjen, datat e zhvillimit të seancave gjyqësore dhe më tej ka shpjeguar se seanca gjyqësore në fjalë është ndërprerë për pak çaste, derisa është realizuar largimi i palës së paditur, e cila tentoi që të bllokojë seancën, duke prishur rregullin e qetësinë e zhvillimit të seancës gjyqësore.

Në aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, gjendet edhe dokumenti “Faturë për arkëtim” nr. {***}, datë 17.09.2018, nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, me përshkrim marrjen e materialeve të hetimit administrativ, në format *hard copy* 1095 fletë dhe 2 CD. Bashkëlidhur saj, gjendet edhe mandatarëtimi i Bankës Raiffeissen, me përshkrim “Derdhje për thesarin nga Ahmet Jangulli për KPK, të ardhura nga fotokopja”, nënshkruar nga Ahmet Jangulli, datë 18.09.2018.

103. Në seancën dëgjimore të datës 03.10.2018, subjekti ka pohuar se ka marrë në dorëzim të gjitha materialet e dosjes së tij të rivlerësimit. Në këtë seancë dëgjimore, relatorja e çështjes ka referuar se një prej denoncimeve rezultoi i shoqëruar me një CD të regjistrimit të një prej seancave gjyqësore të një çështjeje të gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, nga ku u konstatua

³⁹ Shih faqen 31 të vendimit nr. 67, datë 05.10.2018, të Komisionit.

komunikim në ton zëri dhe fjalor jo në përputhje me rregullat e etikës së një magjistrati, për të cilët subjektit iu kërkuan shpjegime, pas kalimit të barrës së provës.

Në përgjigje të gjetjeve të relatores, subjekti është përgjigjur se rrethanat e faktit janë trajtuar në mënyrë jokorrekte nga publiku, pasi rastet nuk rezultojnë të tilla dhe se denoncimet e paraqitura nga palë ndërgjyqëse në proces, që ceken nga interesa në vendimmarrjet përkatëse, nuk mund të konsiderohen si denoncime nga publiku.

104. Nga analiza e dokumentacionit të administruar nga Komisioni, si më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit është njoftuar për denoncimet e publikut dhe është ftuar të japë shpjegime në lidhje me to. Subjekti ka marrë materialet e dosjes së rivlerësimit dhe në seancë dëgjimore nuk ka shfaqur asnjë pretendim në lidhje me mosnjohjen me audion e seancës gjyqësore, pjesë e denoncimit. Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës dhe ai ka dhënë shpjegimet e tij mbi rezultatet e hetimit, si edhe shpjegimet në seancë dëgjimore. Pretendimi i subjektit se nuk është njohur me CD-në e denoncimit dhe se ka qenë në pamundësi për të dhënë shpjegime në lidhje me shkeljen e etikës, është i pabazuar.

Pretendimi i subjektit i shprehur edhe në ankim, se denoncimet e publikut nuk mund të konsiderohen të tilla, sepse publiku janë palët ndërgjyqëse që preken në interesa nga vendimmarrjet përkatëse, vlerësohet nga trupi gjykues se është i pabazuar, pasi denoncimet e publikut, ndër të cilët edhe ai i shtetasit S.K., janë administruar nga Komisioni në përputhje me nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, i cili në pikat 1 dhe 2 të tij përcakton qartë se: “Çdo person që vjen në dijeni të fakteve ose rrethanave që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit, ka të drejtë të informojë drejtpërdrejt institucionet e rivlerësimit. Informacioni duhet të përmbajë përshkrimin e të dhënave për të vlerësuar shkeljen ligjore, sipas kriterëve të rivlerësimit, veçanërisht për veprimin ose praktikën e dyshuar, pasojat ligjore, rrethanat për faktet që krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore, si dhe të dhënat mbi identitetin e personit”.

105. Subjekti pretendon se komunikimi i tij ka qenë krejt korrekt dhe në të nuk mund të gjenden sjellje të papërshtatshme që dëmtojnë figurën e magjistratit. Në lidhje me këtë pretendim, trupi gjykues verifikoi audion e përcjellë nga denoncuesi bashkëlidhur denoncimit, dhe konstaton se në një seancë gjyqësore me paditës z. S.K. (denoncuesi) dhe palë të paditur {***}, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e kryesuesit të seancës gjyqësore si gjyqtar i vetëm, i drejtohet paditësit me një komunikim të ashpër, tone të larta dhe shprehje jo të denja për sallën e gjyqit dhe për etikën e gjyqtarit. Edhe pas nxjerrjes së paditësit jashtë sallës së gjyqit, komunikimi i subjektit ka vazhduar të jetë joetik edhe me palën e paditur.

Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se subjekti, me këtë mënyrë komunikimi, ka shkelur rregullin 8 të Kodit të Etikës Gjyqësore, miratuar nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare, më datë 08.12.2006, sipas të cilit: “Gjyqtari duhet të sigurojë rregull dhe respektim të solemnitetit gjatë seancave gjyqësore. Sjellja e tij ndaj pjesëmarrësve në seancat gjyqësore duhet të jetë e paanshme dhe dinjitoze. Këtë sjellje ai duhet ta kërkojë edhe nga palët në proces, nëpunësit gjyqësorë dhe persona të tjerë që u nënshtrohen urdhrave dhe kontrollit të gjykatës”. Trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit në vendim, se subjekti ka kryer shkelje të standardeve të etikës dhe rregullave të sjelljes së magjistratit nëpërmjet komunikimit të papërshtatshëm me palët në proces, duke cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

106. Në lidhje me pretendimin e subjektit se arsyetimi i Komisionit është joligjor, pasi rivlerësimi kalimtar nuk është brenda periudhës së vlerësimit, trupi gjykues vlerëson se analizimi i denoncimit të publikut nga Komisioni është kryer në përputhje me parashikimet ligjore të ligjit nr. 84/2016, i cili në nenin 53 të tij detyron organet e rivlerësimit të verifikojnë dhe të hetojnë e vlerësojnë faktet e denoncuar nga publiku.

Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

Dh) Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për vlerësimin tërësor të çështjes dhe shkaqet e ankimit lidhur me të

107. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se konkluzioni i Komisionit se ka cenuar besimin e publikut, është abuziv dhe joligjor, pasi ky përfundim nuk gjen vend në rezultatet e hetimit administrativ. Në vlerësimin tërësor të çështjes, Komisioni nuk referon provat, arsyet dhe dispozitat mbi të cilat mbështetet akti. Në një qëndrim ligjor kërkohet cenimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë në një gjendje të tillë, që të jetë në kushtet pamundësisë për të plotësuar mangësitë nëpërmjet programit të trajnimit, ku jo më kot në parashikimin ligjor ligjvënësi ka përdorur lidhësen “dhe”, që nuk lë vend për tjetër interpretim.*

Trupi gjykues konstaton se në vendim, Komisioni duke analizuar konstatimet për secilin nga kriteret e vlerësimit, ka arritur në përfundimin se në vlerësimin tërësor të tri kriterëve në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, referuar nenit 61, pika 5 e po këtij ligji.

108. Në lidhje me pretendimin e subjektit se konkluzioni i Komisionit se ai ka cenuar besimin e publikut, është abuziv dhe joligjor, pasi ky përfundim nuk gjen vend në rezultatet e hetimit administrativ, trupi gjykues vlerëson se Komisioni ka konkluduar pas analizës së përfundimeve të arritura për të tria kriteret e vlerësimit në fazën fundore të procesit, gjatë vendimmarrjes për vlerësimin e subjektit, pasi ky i fundit ka dhënë shpjegimet mbi rezultatet e hetimit dhe pasi ka shprehur qëndrimin e tij përfundimtar në seancë dëgjimore, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

109. Në lidhje me pretendimin e subjektit se në vlerësimin tërësor të çështjes, Komisioni nuk referon provat, arsyet dhe dispozitat mbi të cilat mbështetet akti, trupi gjykues vlerëson se Komisioni në vendim, ka referuar në elementet e cenimit të besimit të publikut, në mbështetje të analizës së bërë mbi provat e administruara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke arritur në përfundimin se subjekti ka kryer deklarime kontradiktore dhe veprime fiktive mbi të ardhurat nga fitimi i aktivitetit të bashkëshortes dhe deklarimet e likuiditeteve *cash*, pranë ILDKPI-së. Për kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni ka arritur në përfundimin se informacioni i dhënë nga DSIK-ja gjen mbështetje edhe nga hetimi administrativ mbi dosjen për veprime të dyshuara si korruptive në bashkëpunim me një prokuror, siç janë rrethanat e ndryshimit të kualifikimit të veprës penale për të akuzuarit. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale ka arritur në përfundimin se subjekti është i papërshtatshëm.

Në lidhje me pretendimin e subjektit se në një qëndrim ligjor kërkohet cenimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë në një gjendje të tillë që të jetë në kushtet pamundësisë për të plotësuar mangësitë nëpërmjet programit të trajnimit, ku jo më kot në parashikimin ligjor ligjvënësi ka përdorur lidhësen “dhe”, që nuk lë vend për tjetër interpretim, trupi gjykues vlerëson se neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “Në rast se nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit”. Në rastin konkret, konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit është i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale, u gjet i drejtë edhe në këtë gjykim. Gjithashtu, trupi gjykues, në mbështetje të analizës së situatës faktike dhe

ligjore të bërë në këtë vendim⁴⁰, duke vlerësuar në tërësi të tria kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, vlerëson se subjekti, duke kryer:

a) deklarime kontradiktore gjatë procesit të rivlerësimit dhe veprime fiktive në vite, për të ardhurat nga fitimi i aktivitetit të bashkëshortes dhe, për rrjedhojë, edhe për deklaratimet e likuiditeteve *cash* në deklaratat periodike të pasurisë dhe në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit;

b) veprime procedurale, gjatë shqyrtimit prej tij të çështjes gjyqësore të analizuar lidhur me vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës, të tilla që duket se kanë favorizuar të pandehurin, i cili është gjykuar në mungesë e për të cilin në përfundim të gjykimit, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm ka deklaruar “pafajësi”; si dhe

c) komunikim të papërshtatshëm me palët në proces, duke shkelur standardet e etikës dhe rregullave të sjelljes së magjistratit, ka shfaqur një sjellje të papranueshme në raport me rolin e gjyqtarit si funksionar i drejtësisë, duke cenuar besimin e publikut te ky sistem.

Në vlerësimin e trupit gjykues, këto rrethana të cituara më lart, janë të mjaftueshme për të aplikuar nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si një prej shkaqeve të shkarkimit nga detyra të subjektit.

Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

110. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi pretendimet dhe kërkimet e subjektit të parashtruara në ankim, parashtrimet e paraqitura prej tij 5 ditë para zhvillimit të seancës gjyqësore në dhomë këshillimi, si dhe provat e administruara gjatë hetimit nga Komisioni për këtë çështje, për të tria kriteret e vlerësimit, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Ahmet Jangulli:

1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

1.1 ka mungesë burimesh të ligjshme financiare për blerjen e automjetit tip “Mercedes Benz” në vitin 2005, siç përcaktohet në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016;

1.2 ka mungesë burimesh për të justifikuar kursimet *cash* të deklaruara si të dhëna hua te personat e tretë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, të krijuara në periudhën 2005-2012, siç përcaktohet në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016;

1.3 ka kryer deklarim të pamjaftueshëm në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, për shkak të mosdeklarimit të detyrimit të personit të lidhur/bashkëshortes së tij në lidhje me kredinë e marrë prej saj në Bankën Societe Generale Albania, në kundërshtim me parashikimet e nenit D, pikat 1 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se me të drejtë Komisioni ka konkluduar se subjekti gjendet në kushtet e nenit D, pikat 1, 3 e 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

⁴⁰ Shih konkluzionet e dhëna në paragrafët 56, 65 dhe 105 të këtij vendimi.

2. Për kriterin e kontrollit të figurës:

trupi gjykues vlerëson se faktet e analizuara nga Komisioni nuk kualifikohen në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi gjatë gjykimit nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk është në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë arsye, e gjen të drejtë pretendimin e tij se nuk ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës.

Trupi gjykues, në analizë të veprimeve procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit të çështjes gjyqësore të evidentuar në këtë kriter vlerësimi, çmon se kjo sjellje procedurale e subjektit cenon besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:

trupi gjykues çmon se në bazë të të gjithave rrethanave dhe kushteve të analizuara për këtë kriter, parregullsitë e konstatuara janë të asaj natyre dhe asaj shkalle, që provojnë se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve, nuk është efektiv, në atë shkallë sa programi i trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës nuk mund ta zgjidhë këtë çështje për një vit, në përputhje me parashikimet e nenit 44, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

Trupi gjykues vlerëson se me të drejtë Komisioni ka konkluduar se subjekti gjendet në kushtet e nenit E, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

4. Nga vlerësimi tërësor i procedurave, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se është i drejtë konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, bazuar në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi:

4.1 Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime kontradiktore gjatë procesit të rivlerësimit dhe veprime fiktive në vite, për të ardhurat nga fitimi i aktivitetit të bashkëshortes dhe, për rrjedhojë, edhe për deklaramet e likuiditeteve *cash* në deklaramet periodike të pasurisë dhe në deklarametën e pasurisë së rivlerësimit.

4.2 Veprimet procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit prej tij të çështjes gjyqësore të analizuar, lidhur me vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës, duket se kanë favorizuar të pandehurin i cili është gjykuar në mungesë, për të cilin në përfundim të gjykimit subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm, ka deklaruar “pafajësi”.

4.3 Subjekti ka kryer shkelje të standardeve të etikës dhe të rregullave të sjelljes së magjistratit nëpërmjet komunikimit të papërshtatshëm me palët në proces.

111. Në përfundim të shqyrtimit të të gjitha shkaqeve të ankimit dhe bazuar në konkluzionet si më sipër, trupi gjykues çmon se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 67, datë 05.10.2018, është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi.

112. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Ahmet Jangulli gjendet në kushtet e neneve D, pikat 1, 3 e 5 dhe E, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 61, pikat 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 67, datë 05.10.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ahmet Jangulli.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 18.11.2019.

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUES

Luan DACI

nënshkrimi